



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 638 Akti

Nr. 788 Vendimi

Tiranë, më 25.07.2024

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Alma Faskaj	Kryesuese
Xhensila Pine	Relatore
Pamela Qirko	Anëtare

në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Ferdinando Buatier de Mongeot, asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Mevi Dibra, datë 25.7.2024, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, zhvilloi seancën dëgjimore lidhur me çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Seladin Pysqyli**, gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë.

OBJEKTI: Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet A, Ç, D, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.**

Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoji rekomandimin e relatores së çështjes, mori në shqyrtim, analizoi provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, dëgjoji në seancë subjektin e rivlerësimit dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Z. Seladin Pysqyli është subjekt rivlerësimi bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë për shkak të funksionit të tij si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë.

2. Bazuar në nenin 14 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, z. Seladin Pysqyli i është nënshtruar procesit të rivlerësimit, duke u

shortuar me trupin gjykues të përbërë nga komisioneret Pamela Qirko, Alma Faskaj dhe Xhensila Pine (relatore).

3. Komisioni administroi nga institucionet ndihmëse të procesit raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Autoriteti Kombëtar i Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor.

4. Trupi gjykues, pas studimit të raporteve të vlerësimit, të hartuara nga institucionet shtetërore, filloi hetimin administrativ sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit. Trupi gjykues caktoi kryesuese komisioneren Alma Faskaj dhe deklaroi mungesën e konfliktit të interesit.

5. Trupi gjykues me vendimin nr. 2 vendosi: (i) të përfundojë hetimin administrativ për subjektin e rivlerësimit Seladin Pysqyli bazuar në tri kriteret e rivlerësimit; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit se referuar nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 i ka kaluar barra e provës mbi rezultatet e hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016; (iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit për t'u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, si dhe me nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative; (iv) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji, për të kërkuar marrjen e provave e thirrjen e dëshmitarëve dhe afatin e ushtrimit të tyre.

6. Në datën 8.7.2024, subjektit iu dërguan rezultatet e hetimit administrativ të Komisionit për sjelljen e provave dhe shpjegimeve për të provuar të kundërtën e barrës së provës. Subjekti paraqiti provat e shpjegimet brenda afatit të përcaktuar nga ana e Komisionit.

II. SEANCA DËGJIMORE

7. Në datën 23.7.2024, në orën 10.00, u zhvillua seanca dëgjimore në prani të subjektit të rivlerësimit dhe vëzhguesit ndërkombëtar, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016. Në përfundim të seancës dëgjimore, subjekti kërkoi konfirmimin në detyrë.

7.1 Seanca dëgjimore u ndërpre për të vijuar me shpalljen e vendimit të trupit gjykues në datën 25.7.2022, ora 09.45.

III. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

A. Vlerësimi i pasurisë

8. Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI) ka dërguar aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të pasurisë të subjektit të rivlerësimit, ku në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera lidhur me këtë subjekt të rivlerësimit ka konstatuar se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar pasuritë;*
- *ka mosdeklarime të pasurisë ndër vite;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

A/1. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

8.1 Pavarësisht se sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” ILDKPKI-ja është autoriteti përgjegjës për kontrollin dhe vlerësimin e pasurisë për subjektet e rivlerësimit, referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese, Komisioni kreu një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi, duke hetuar në mënyrë

të pavarur të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, nga ku rezultoi si vijon:

Apartament banimi me sipërfaqe 134.57 m², në *, Tiranë, vlera 5.600.000 lekë**

9. Në deklaratën *Vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *“I janë dhënë djalit O.P 5.200.000 lekë për blerjen e një apartamenti në ***. Një pjesë me këste në bazë të kontratës premtim shitjeje dhe pjesa tjetër në kohën e lidhjes së kontratës. Shuma është siguruar duke tërhequr depozitat e kursimit nga BKT-ja dhe Union Bank”.*

10. Në deklaratën *Vetting*, personi i lidhur me subjektin, djali i tij ka deklaruar: *“Një apartament banimi të ndodhur në ***, Tiranë, blerë me kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 9.3.2015. Burimi i të ardhurave nga prindërit, babai Seladin Pysqyli, shuma prej 5.200.000 lekësh dhe 400.000 lekë të miat, fituar nga lojëra fati dhe ndihma e familjes. Vlera: 5.600.000 lekë”.*

11. Në formularin e të dhënave konfidenciale në deklaratën periodike të vitit 2014, subjekti ka deklaruar: *“I kam dhënë një shumë prej 280.000 lekësh shoqërisë “***” sh.p.k., me përfaqësues shtetasin E.B, prenotim për blerjen e një apartamenti në emër të djalit O.P, në komunën ***, zona e emërtuar “***”. Marrëveshja është bërë më shkrim, por jo para noterit”.*

12. Në deklaratën periodike të interesave të vitit 2015, subjekti ka deklaruar: *“Shpenzuar për blerjen e një apartamenti banimi në *** me nr. pasurie ***, në favor të djalit O.P. Origjina e kësaj pasurie është nga kursimet prej të ardhurave që pas vitit 1991 deri në vitin 2014 dhe interesat bankarë në ish-Bankën e Kursimeve, në Raiffeisen Bank, BKT dhe Union Bank sh.a. Dokumentacioni është paraqitur periodikisht edhe gjatë verifikimit të bërë në ILDKPKI për periudhën 2003 – 2013. Shuma: 4.920.000 lekë”.*

13. Personi i lidhur me subjektin, djali i tij, në DPV-në e vitit 2015 ka deklaruar: *“Një apartament banimi të ndodhur në ***, Tiranë, me nr. pasurie ***. Ky apartament është blerë nga shoqëria “***” sh.p.k., me kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 9.3.2015. Nga ana ime është paguar një shumë prej 400.000 lekësh që e kam pasur dhe deklaruar më parë, kurse pjesa tjetër prej 4.920.000 lekësh është paguar nga prindërit e mi, babai Seladin Pysqyli. Fillimisht është paguar nga babai një shumë prej 280.000 lekësh, në vitin 2014, në bazë të kontratës së sipërmarrjes datë 4.1.2014, kurse pjesa tjetër gjatë vitit 2015. Vlera: 5.600.000 lekë”.*

14. Deklaratës *Vetting* i janë bashkëlidhur:

- Kontratë sipërmarrjeje, hartuar para noteres Dh.Q, datë 4.1.2014, për porositje apartamenti me sipërfaqe totale 134.57 m², nga e cila 124.14 m² sipërfaqe apartamenti dhe 10.43 m² sipërfaqe e përbashkët.

- Kontratë shitjeje, hartuar para noteres Dh.Q, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 9.3.2015, për blerje apartamenti me sipërfaqe totale 124.14 m². Blerës: O.P. Shitës: Shoqëria “***” sh.p.k. Çmimi: 5.600.000 lekë. Pagesa prej 3.360.000 lekësh është paguar sipas kontratës së sipërmarrjes datë 4.1.2014, kësti i dytë prej 2.240.000 lekësh nëpërmjet Alpha Bank.

15. Në lidhje me depozitat e kursimit në BKT, subjekti në këtë formular ka deklaruar: *“Të ardhurat nga interesat e depozitës në BKT, dhjetor 2007 – dhjetor 2009. Kjo depozitë është krijuar nga tërheqja e depozitës në Raiffeisen Bank së bashku me interesat, gjithsej 1.727.543 lekë, së cilës i është shtuar shuma 272.500 lekë dhe është krijuar depozitë në shumën 2.000.000 lekë”.*

16. ASHK Drejtoria Vendore Tirana ***, me shkresën nr. *** prot., datë 15.2.2021, informon Komisionin se në emër të shtetasit O.P rezulton e regjistruar pasuria nr. ***, vol. ***, faqe ***, z. k. ***.

17. Nga hetimi i kryer prej Komisionit lidhur me këtë pasuri kanë rezultuar faktet si vijojnë:

17.1 Referuar kartelës së pasurisë, rezulton se kjo pasuri ka qenë me barrë hipotekore, pasi është regjistruar kontratë hipotekimi me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 1.11.2013, midis palëve M.B dhe shoqëria “****” sh.p.k., me objekt “Vënien e hipotekës mbi objektin apartament banimi” për kontratën e huas nr. *** rep., nr. *** kol., datë 4.11.2013, me palë huadhënëse shtetasin M.B, palë huamarrëse shtetasin F.T dhe dorëzënës shoqërinë “****” sh.p.k.

17.2 Me shkresën nr. *** prot., datë 4.2.2021, FSHU-ja informon Komisionin se me gjeneralitetet O.P, referuar të dhënave të sistemit të faturimit, identifikohet një abonent me kontratë furnizimi në Tiranë, ku është evidentuar ndryshimi i emrit të abonentit nga A.G në O.P në vitin 2016.

17.3 Referuar fakteve të mësipërme rezultuar nga hetimi administrativ, Komisioni hetoi për historikun e kësaj prone, duke i kërkuar informacion noteres mbi transaksionet e kryera mbi këtë pronë, te cilat rezultuan si vijon:

- a) Në datën 15.2.2012, pranë noteres Dh.Q është lidhur kontrata e sipërmarrjes nr. *** rep., nr. *** kol., midis shoqërisë “****” sh.p.k., përfaqësuar nga z. E.B, dhe shtetasit F.T, sipas së cilës shoqëria ka marrë përsipër të ndërtojë apartamentin nr. 4, kati i parë i banimit, kulla 1, shtetasit F.T, kundrejt çmimit 73.034 euro.
- b) Me deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 2.3.2012, redaktuar nga noterja Dh.Q, shoqëria “****” sh.p.k. deklaron se është likuiduar totalisht nga z. F.T. Sipas kësaj deklaratë, shoqëria “****” sh.p.k. deklaron se shuma 73.034 euro është marrë e plotë dhe nuk ka asnjë pretendim as sot, as në të ardhmen në lidhje me këtë shumë.
- c) Në datën 27.3.2012, mes palëve A.G dhe F.T dhe shoqërisë “****” sh.p.k., përfaqësuar në këtë kontratë nga z. E.B, pranë noteres Dh.Q është lidhur kontrata paraprake e shitjes për apartamentin nr. ***, kati i *** i banimit, kulla ***, sipas së cilës shtetasi F.T i shet shtetasit A.G apartamentin në vlerën 73.034 euro, duke deklaruar se ajo është paguar nga shtetasi A.G (në emër të të cilit figuronte kontrata e energjisë, para se te ndërrohej në emër të djalit të subjektit) dhe shoqëria “****” sh.p.k. ka shprehur dakordësinë e saj lidhur me këtë transaksion.
- d) Në datën 9.3.2015, tek noterja Dh.Q është lidhur kontrata e shitjes nr. *** rep., nr. *** kol.; në datën 9.3.2015 pala shitëse “****” sh.p.k., përfaqësuar në këtë kontratë nga z. E.B sh.p.k., shet apartamentin në katin e parë të banimit në ***, Tiranë, blerësit O.P, kundrejt çmimit 5.600.000 lekë.
- e) Në të njëjtën datë, më 9.3.2015, tek e njëjta notere, znj. Dh.Q, mes palëve A.G dhe E.B është hartuar dhe nënshkruar deklarata noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., sipas së cilës shtetasi E.B deklaronte se i ka marrë hua shumën 73 mijë euro shtetasit A.G.

17.4 Referuar të dhënave të QKB-së, datë 13.6.2014, për shoqërinë “****” sh.p.k. është depozituar kërkesa për vendosjen e barrës së sigurisë mbi titujt e pronësisë dhe në datën 11.2.2015 është urdhëruar moskryerja e asnjë veprimi. Në ditën e nënshkrimit të kontratës së shitjes, më 9.3.2015, midis djalit të subjektit dhe shoqërisë ndërtuese “****” sh.p.k., kjo e fundit ka qenë e bllokuar dhe nuk mund të kryente asnjë veprim.

17.5 Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të paraqitur shpjegime/prova për të provuar të kundërtën e konstatimit të Komisionit. Nga analiza e fakteve duket se palët kanë pasur si qëllim shmangien e deklaratimit të vlerës reale të përfitimit të kësaj pasurie të paluajtshme, e cila referuar gjithë dokumentacionit të administruar duket se është 73.000 euro.

17.6 Referuar arsyetimit të mësipërm, vlera 73.034 euro është përfshirë në analizën financiare për pagimin e apartamentit në datën 9.3.2015.

Burimi i krijimit të kësaj pasurie

Në lidhje me shumën 400.000 lekë

18. Në deklaratën *Vetting*, personi i lidhur me subjektin, i biri, ka deklaruar: “*Burimi i të ardhurave 400.000 lekë, fituar nga lojëra fati dhe ndihma e familjes*”.

19. Sipas të dhënave bankare, në datën 27.5.2013, në Alpha Bank djali i subjektit ka derdhur në llogari shumën prej 400.000 lekësh. Në datën 5.1.2015 është tërhequr nga kjo bankë shuma prej 433.300 lekësh. Personi i lidhur me subjektin, djali, në moshë madhore, ka plotësuar deklaratën e interesave privatë për herë të parë në vitin 2014 dhe në këtë deklaratë nuk ka deklaruar kursime apo të ardhura.

20. Në DPV-në e vitit 2015, ai deklaroi të ardhura nga puna në *call center* shumën 50.000 lekë. Nuk deklaroi llogari bankare në emrin e tij dhe as burimin e krijimit të saj. Vetëm në deklaratën *Vetting* deklaroi shumën prej 400.000 lekësh, me burim nga lojërat e fatit dhe ndihma e familjes.

Sa më sipër, duket se nuk provohet me ligjshmëria e burimit të shumës prej 400.000 lekësh.

Në lidhje me shumën 5.200.000 lekë

21. Në deklaratën *Vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “*I janë dhënë djalit 5.200.000 lekë për blerjen e një apartamenti në ***. Shuma është siguruar duke tërhequr depozitat e kursimit nga BKT dhe Union Bank*”.

22. Subjekti në pyetësin nr. 3 sqaron se burimi i likuiditetit të kësaj shume kanë qenë:

- *Kursimet nga paga. Jam emëruar në detyrën e ndihmësgjyqtarit në muajin nëntor 1993 në Gjykatën e Rrethit Korçë, kurse në muajin maj 1995 jam emëruar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Devoll. Në datën 1.6.1998, Gjykata e Rrethit Devoll ka mbyllur veprimtarinë e saj dhe nga ajo kohë funksionin e gjyqtarit e ushtror në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë. Po kështu, kam qenë në marrëdhënie pune si kuadër me arsim të lartë prej vitit 1985 deri në tetor 1992. Në lidhje me këtë kam dorëzuar si provë librezën e punës.*

- *Të ardhurat e tij nga toka bujqësore, për të cilën punët i ndiqte motra dhe nëna, që në atë kohë ishte në moshë jo të madhe dhe në gjendje shëndetësore të mirë.*

- *Të ardhurat e bashkëshortes nga toka bujqësore. Bashkëshortja ka punuar edhe tek shoqëritë “***” sh.p.k. dhe “***” sh.a. dhe ka të dokumentuara të ardhura në shumën prej 648.164 lekësh, për të cilat ka dorëzuar dokumentacionin përkatës. Të ardhurat e saj në këto dy shoqëri kanë qenë shumë më të mëdha, por nuk janë dokumentuar të gjitha nga këto shoqëri, për arsye që ata i dinë. Në atë kohë paga jepej në dorë, jo nëpërmjet bankës, dhe këtë fakt bashkëshortja e ka mësuar në kohën kur ka kërkuar dokumentacionin për plotësimin e deklaratës përmbledhëse.*

Në lidhje me dokumentacionin provues, me përgjigjet e pyetësorit nr. 2 kam vënë në dispozicion mandatpagesën datë 7.3.2000 dhe urdhërderdhjen datë 20.1.2003 nga ish-Banka e Kursimeve dhe

*tri mandate veprim arke të Raiffeisen Bank. Në lidhje me bashkëshorten, kam dorëzuar vërtetimet nga shoqëria “***” sh.p.k. dhe “***” sh.a.”.*

Në lidhje me të ardhurat e përfituara nga toka bujqësore

Deklarimet e subjektit në lidhje me të ardhurat e përfituara nga toka bujqësore

23. Subjekti dhe bashkëshortja kanë deklaruar në deklaratat e interesave privatë të ardhura nga bujqësia si vijon:

Në DPV-në e vitit 2007, subjekti deklaroi të ardhura nga toka bujqësore dhe kursime nga paga në shumën 250.000 lekë.

Në DPV-në e vitit 2008, në formularin e pasurive të paluajtshme dhe të luajtshme, subjekti ka deklaruar të ardhura nga toka bujqësore 150.000 lekë.

Në DPV-në e vitit 2009, subjekti ka deklaruar të ardhura nga toka bujqësore në shumën 120.000 lekë.

Në DPV-në e vitit 2011, në formularin e pasurive të paluajtshme dhe të luajtshme, subjekti ka deklaruar të ardhura nga toka bujqësore në shumën 180.000 lekë.

Në DPV-në e vitit 2012, në formularin e pasurive të paluajtshme dhe të luajtshme, subjekti ka deklaruar të ardhura nga toka bujqësore në shumën 170.000 lekë.

Në DPV-në e vitit 2013, subjekti ka deklaruar të ardhura nga toka bujqësore në shumën 200.000 lekë; shtesa në lekë.

Në DPV-në e vitit 2014, në formularin e të ardhurave, subjekti ka deklaruar të ardhura nga toka bujqësore në shumën 100.000 lekë.

Në DPV-në e vitit 2015, subjekti ka deklaruar 130.000 lekë të ardhura nga toka bujqësore.

Në DPV-në e vitit 2016, subjekti ka deklaruar të ardhura nga toka bujqësore në shumën 90.000 lekë.

23.1 Lidhur me të ardhurat nga toka bujqësore gjatë periudhës 1993 – 2016, të deklaruara nga subjekti në shumën rreth 1.300.000 lekë, të cilat kanë shërbyer si burim krijimi për likuiditetet në bankë dhe, më pas, për krijimin e pasurisë apartament në ***, ato nuk janë përfshirë në analizën financiare, për shkak se për këto të ardhura nga toka bujqësore me sa duket nuk provohet realizimi faktik dhe as masa e tyre.

Deklarimet e bashkëshortes në lidhje me të ardhurat e përfituara nga toka bujqësore

Në DPV-në e vitit 2008, bashkëshortja e subjektit ka deklaruar: *“Të ardhura nga toka bujqësore në shumën 100.000 lekë”.*

Në DPV-në e vitit 2009, bashkëshortja e subjektit ka deklaruar: *“Të ardhura nga toka bujqësore 100.000 lekë”.*

Në DPV-në e vitit 2010, bashkëshortja e subjektit ka deklaruar: *“Të ardhura nga toka bujqësore 150.000 lekë”.*

Në DPV-në e vitit 2011, bashkëshortja e subjektit ka deklaruar: *“Shtesa në lekë, të ardhura nga toka bujqësore 150.000 lekë”.*

Në DPV-në e vitit 2012, bashkëshortja e subjektit ka deklaruar: *“Shtesa në lekë, të ardhura nga toka bujqësore 120.000 lekë”.*

Në DPV-në e vitit 2013, bashkëshortja e subjektit ka deklaruar: *“Shtesa në lekë, të ardhura nga toka bujqësore 150.000 lekë”*.

Në DPV-në e vitit 2014, bashkëshortja e subjektit ka deklaruar: *“Të ardhura nga toka bujqësore në shumën 100.000 lekë”*.

Në DPV-në e vitit 2015, bashkëshortja e subjektit ka deklaruar: *“Të ardhura nga toka bujqësore 120.000 lekë”*.

Në DPV-në e vitit 2016, bashkëshortja ka deklaruar: *“Të ardhura nga toka bujqësore 100.000 lekë”*.

23.2 Lidhur me të ardhurat e bashkëshortes nga toka bujqësore gjatë periudhës 1992 – 2016, në shumën rreth 900.000 lekë, shërbyer si burim krijimi për likuiditetet në bankë dhe, më pas, për krijimin e pasurisë apartament në ***, ato nuk janë përfshirë në analizën financiare, për shkak se për këto të ardhura nga toka bujqësore me sa duket nuk provohet realizimi faktik dhe as masa e tyre.

24. Në lidhje me gjendjen cash te deklaruar

25. Subjekti në deklaratën *Vetting* ka deklaruar: *“Gjendje cash në shtëpi, kursime nga të ardhurat e familjes sime si subjekt rivlerësimi dhe të bashkëshortes. Vlera e deklaruar: 350.000 lekë”*.

26. Subjekti deklaroi kursime për herë të parë në vitin 2007, si vijon.

Në DPV-në e vitit 2007 deklaroi: *“Të ardhura nga toka bujqësore dhe kursime nga paga – 250.000 lekë”*.

Në DPV-në e vitit 2008 deklaroi: *“Kursime nga paga – 100.000 lekë”*.

Në DPV-në e vitit 2009 deklaroi: *“Kursime nga paga – 300.000 lekë”*.

Në DPV-në e vitit 2010 nuk deklaroi kursime.

Në DPV-në e vitit 2011 deklaroi: *“Shtesa në lekë, kursime nga paga vjetore – 200.000 lekë”*.

Në DPV-në e vitit 2012 deklaroi: *“Shtesa në lekë, kursime nga paga vjetore – 150.000 lekë”*.

Në DPV-në e vitit 2013 deklaroi: *“Shtesa në lekë, kursime nga paga vjetore – 250.000 lekë”*.

Në DPV-në e vitit 2014 deklaroi: *“Kursimet për periudhën 1.1.2014 – 31.12.2014, duke zbritur shumën 280.000 lekë janë në shumën 200.000 lekë”*.

Në DPV-në e vitit 2015 deklaroi: *“Kursimet për periudhën 1.1.2015 – 31.12.2015 janë në shumën 250.000 lekë, depozitë në Union Bank – 250.000 lekë”*.

Në DPV-në e vitit 2016 deklaroi: *“Të ardhurat e familjes së bashku me bashkëshorten janë në shumën 1.585.799 lekë, nga të cilat 500.000 lekë kursime, kurse pjesa tjetër shpenzime të përditshme të familjes dhe për fëmijët madhorë. Nga kursimet 200.000 lekë depozitë në Union Bank, 168.301 lekë në llogarinë e pagës në Union Bank dhe pjesa tjetër gjendje në shtëpi”*.

26.1 Në lidhje me gjendjen cash, subjektit të rivlerësimit i është kërkuar të saktësojë gjendjen cash nga viti 2007 deri në vitin 2016, ku nëpërmjet pyetësorit nr. 3, datë 18.4.2024, subjekti sqaron se: *“Gjendja cash për këtë periudhë ka qenë e ndryshueshme. Burimi i saj ka qenë nga paga, të ardhurat nga puna e bashkëshortes dhe të ardhurat nga toka bujqësore. Kjo shumë është përdorur në vijimësi për shpenzimet familjare dhe blerjen e automjeteve, kurse një pjesë është deklaruar depozitë kursimi”*.

26.2 Nga hetimi administrativ rezulton se subjekti në asnjë nga deklaratat periodike vjetore nuk ka deklaruar pakësim e as përdorim të kursimeve. Komisioni ka marrë në konsideratë në analizën

financiare gjendjen e likuiditetit *cash* në banesë sipas deklarimeve të subjektit të rivlerësimit në DPV-të vjetore (2007 – 2016).

Analiza financiare për pagimin e vlerës së apartamentit në datën 9.3.2015

27. Nga verifikimi i llogarive bankare dhe lëvizjeve në to, rezultoi se subjekti i rivlerësimit kryen këto veprime:

28. Nga llogaria e kursimit të subjektit tek Union Bank, me nr. ***, ai tërheq në datën 6.1.2015 shumën 1.300.000 lekë. Nga llogaria në emër të subjektit dhe bashkëshortes së tij tek BKT tërheq në datën 6.1.2015 shumën 3.499.569 lekë.

29. Komisioni kreu analizën e mundësisë së pagesës me burim kursimet e subjektit tek Union Bank dhe BKT-ja, referuar tërheqjeve të bëra në këto banka, përkatësisht në shumat 1.300.000 lekë dhe 3.499.569 lekë në datën 6.1.2015.

30. Në lidhje me krijimin e këtyre likuiditeteve bankare, në nëntor të vitit 2005 ato ishin në shumën 1.224.790 lekë, krijuar fillimisht si depozitë tek ish-Banka e Kursimeve në datën 20.1.2003, nëpërmjet depozitimit të bërë nga subjekti i rivlerësimit në shumën 800.000 lekë.

31. Bashkimi i gjendjes së depozitave në emër të subjektit në shumën 1.224.790 lekë krijoi një depozitë të re pranë Raiffeisen Bank në vitin 2005, në shumën totale 1.614.000 lekë. Sipas analizimit të mësipërm, nuk është vërtetuar burimi i krijimit të kësaj depozite.

32. Pas maturimit të saj më 10.12.2007, vlera e tërhequr nga Raiffeisen Bank në shumën 1.727.543 lekë shërben si burim për krijimin në të njëjtën datë të depozitës në vlerën 2.000.000 lekë pranë BKT-së. Në po këtë vit, subjekti i rivlerësimit ka blerë edhe automjetin tip “****” sipas kontratës së datës 28.2.2007, në shumën 420.000 lekë.

33. Kjo depozitë në emër të subjektit të rivlerësimit, në shumën 2.000.000 lekë, pasi maturohet në shumën 2.240.000, në datën 17.12.2009, bashkohet me një derdhje të bërë nga bashkëshortja e subjektit në shumën 260.000 lekë po në të njëjtën datë, duke krijuar një depozitë të re tek BKT në emrin e tij dhe bashkëshortes së tij, në shumën 2.500.000 lekë.

34. Në datën 9.12.2009, subjekti krijon dhe një depozitë në emrin e tij pranë Union Bank, në shumën 150.000 lekë.

35. Në vitin 2012 bëhen dy shtesa mbi këto depozita. Njëra bëhet përmes një derdhjeje në shumën 300.000 lekë, në datën 29.3.2012, tek BKT, dhe tjetra përmes një derdhjeje në shumën 400.000 lekë, në datën 19.12.2012, tek Union Bank. Më pas, vlera e akumuluar tek Union Bank nga depozita e vjetër prej 150.000 lekësh, depozitimi prej 400.000 lekësh dhe shtesat e tjera nga interesat krijojnë një depozitë prej 600.000 lekësh në vitin 2012.

36. Tek Union Bank shtohen edhe depozita të tjera, në vitin 2013 dhe 2014, duke arritur në një vlerë të akumuluar prej 1.300.000 lekësh në datën 6.1.2015. Kjo vlerë tërhiqet nga subjekti në këtë datë dhe duket se shërben për pagesën e kësteve për blerjen e apartamentit në emër të djalit O.P.

37. Vlera e akumuluar nga shtesat e depozitimeve dhe interesave tek llogaria e depozitës pranë BKT-së në emër të subjektit dhe bashkëshortes arrin një vlerë prej 3.499.569 lekësh në datën 6.1.2015. Në këtë datë, kjo shumë tërhiqet nga bashkëshortja e subjektit dhe duket se shërben për pagesën e kësteve për blerjen e apartamentit në emër të djalit O.P.

38. Komisioni kreu analizën financiare referuar dokumentacionit ligjor të administruar. Nga analiza financiare e kryer lidhur me depozitat bankare dhe krijimin e shtimin e tyre ndër vite, rezultoi se

subjekti nuk ka mundur të provojë burimin e ligjshëm të likuiditeteve bankare në shumën 1.300.000 lekë tek Union Bank dhe shumën 3.499.569 lekë tek BKT-ja, në emër të subjektit dhe bashkëshortes së tij, të cilat janë përdorur për pagesën e apartamentit në emër të djalit.

39. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës për të paraqitur shpjegime/prova për të provuar të kundërtën e konstatimit të Komisionit dhe duket se subjekti e personi i lidhur me të kanë kryer deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë. Palët duket se kanë ndërmarrë hapa për shmangien e deklaramit të vlerës reale të përfitimit të kësaj pasurie të paluajtshme dhe kanë mungesë burimesh të ligjshme për të justifikuar pasurinë, duke rezultuar me një pamundësi financiare prej -4.858.480 lekësh.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

40. Pas kalimit të barrës së provës, subjekti, ndër të tjera, ka prapësuar si vijon në lidhje me veprimet juridike: *“Si unë, edhe djali nuk kemi pasur asnjë djeni. Në qoftë se do të ishim në djeni, referuar edhe përvojës së punës, nuk do ta lejoja kurrësi djalin për të hyrë në këtë marrëdhënie shitblerjeje, për më tepër që në kohën e hartimit të kontratës i takonte noteres të bënte verifikimet dhe sqarimet, pasi ajo kishte akses për të bërë verifikimin pranë ish-ZVRPP Tiranë, sot ASHK-ja.*

Duke mos ditur këto veprime, djali ka bërë marrëveshjen, pasi ka rënë dakord me çmimin dhe një pjesë e punimeve u kryen pas marrëveshjes. Pasi më janë vënë në dispozicion rezultatet e hetimit administrativ dhe jam njohur me veprimet juridike si më sipër, djali ka mundur të sigurojë numrin e telefonit të përfaqësuesit të shoqërisë, z. E.B, dhe unë kam kontaktuar me të duke e pyetur pse ishin kryer ato veprime noteriale dhe cili ka qenë qëllimi i tyre.

Ai më është përgjigjur se ato veprime janë kryer në kuadrin e huave që kishin dhe asnjëherë nuk kanë pasur për qëllim shitjen e apartamentit. Apartamenti është vendosur vetëm si garanci, megjithëse ishte i papërfunduar dhe është kjo arsyeja që pronësia e apartamentit nuk ka kaluar asnjëherë tek ata persona, por ka qenë gjithmonë e shoqërisë. Shuma prej 73,000 euro nuk ka qenë asnjëherë çmimi i apartamentit dhe çmimi i parë që është vendosur për shitje është 5,600,000 lekë. Ky shtetas u shpreh i gatshëm për të sqaruar këtë rrethanë dhe deklaroi se mund të ishte pyetur në lidhje me këtë fakt.

Çmimi real i apartamentit është ai i pasqyruar në kontratë dhe për blerjen e tij është paguar vetëm shuma 5.600.000 lekë dhe asnjë lek më shumë. Në lidhje me burimin e të ardhurave për shumën 5,200,000 lekë dhënë djalit nga ana ime për blerjen e apartamentit, ashtu siç kam shpjeguar më sipër, kjo shumë mbulohet nga të ardhurat e familjes ndër vite e interesat bankarë”.

Në lidhje me shumën 400,000 lekë, që djali ka deklaruar nga lojëra fati dhe kursime nga lekët e dhëna nga familja ndër vite, sqaroi se ai e ka pasur mundësinë për të mbledhur këtë shumë, nuk ka pasur shpenzime të tjera dhe kursente paratë që i jepeshin nga familja, me qëllimin për t'i përdorur në qoftë se do t'i nevojiteshin gjatë vijimit të arsimit të lartë”.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

41. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaramet e subjektit të rivlerësimit në deklaramtën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e ILDKPKI-së, deklaramtat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i

rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës dhe deklaramet në seancën dëgjimore – arsyeton se:

42. Pikat 1, 2 dhe 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, pika 1 e nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, pika 7 e udhëzimit të ILDKPKI-së, datë 10.10.2016, si dhe formulari i deklaramet të pasurisë për procesin e rivlerësimit, detyron subjektin e rivlerësimit për deklaramet saktësisht dhe mjaftueshëm të pasurisë dhe të personave të lidhur me burimin në momentin e krijimit të saj, ku me burim në këtë rast është origjina, veprimi i ligjshëm që passjell disponimin dhe të drejtat pronësore të pasurisë, si dhe mjetet financiare për krijimin e saj.

Lidhur me deklaramet e kësaj pasurie

43. Siç është provuar nga hetimi administrativ në kohën e hartimit të dokumentacionit ligjor për përfitimn e pasurisë, veprimet fillestare u deklarua se u kryen nga subjekti i rivlerësimit në vitin 2014, duke deklaruar se ai i ka dhënë një shumë prej 280.000 lekësh shoqërisë “****” për prenotim për blerjen e një apartamenti për djalin e tij. Këto janë fakte që vijnë në kundërshtim me shpjegimet e subjektit pas barrës së provës, sipas të cilave: *“Duke mos ditur këto veprime, djali ka bërë marrëveshjen, pasi ka rënë dakord me çmimin dhe një pjesë e punimeve u kryen pas marrëveshjes”,* fakte që u konsideruan si përpjekje të subjektit për të deformuar apo manipuluar të vërtetën në funksion të paraqitjes së rreme të të dhënave lidhur me pasurinë.

44. Nga përgjigjet e subjektit pas rezultateve të hetimit administrativ, ai nuk mundi të shpjegojë se si ai dhe familjarët e tij arritën të kontaktojnë me shoqërinë e pezulluar dhe pa aktivitet dhe si mundën të përfitojnë këtë pasuri të paluajtshme me 1/2-ën e vlerës së transaksioneve të mëparshme. Çmimi i deklaruar në hartimin e kontratës së shitblerjes korrespondonte me mundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit në vitin 2015, vlerën e tërhequr nga llogaritë bankare prej 5.200.000 lekësh.

45. Shpjegimi i subjektit se veprimet e mëparshme ligjore ishin kryer në kuadër të huave nga palët e mëparshme dhe që asnjëherë nuk kanë pasur për qëllim shitjen e apartamentit, nuk përputhej me faktet reale dhe historikun e transaksioneve të kryera mbi këtë pronë. Duke mos u ndalur në vlerësimin e karakterit ngushtësisht civil të kontratave dhe deklaratave noteriale për marrëdhëniet mes palëve dhe duke pasur parasysh që procesi i rivlerësimit ka natyrë administrative e ka për objekt deklaramet dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, nga faktet e referuara nga hetimi administrativ, trupi gjykues vlerësoi se marrëveshja e palëve në rastin konkret ka pasur si qëllim shmangien e deklaramet të vlerës reale të përfitimt të kësaj pasurie të paluajtshme.

46. Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka arritur të provojë të kundërtën e barrës së provës lidhur me ligjshmërinë e veprimit të kryer për përfitimn e kësaj pasurie sipas parashikimeve të nenit 33, pika 5 dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, të analizuara edhe me parashikimin në nenin D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës.

Lidhur me mundësinë financiare

47. Pasi vlerësoi shpjegimet dhe dokumentacionin e paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni çmon se vlera 400.000 lekë, e paguar nga djali i subjektit, mbeti e paprovuar për sa i përket ligjshmërisë së saj, deklaruar e përfutur nga lojërat e fatit të djalit të subjektit.

47.1 Nga të dhënat e administruara në drejtim të verifikimeve të burimit të krijimit të likuiditeteve në bankë nga djali i subjektit të rivlerësimit pranë Alpha Bank, Komisioni ka arritur në konkluzionin se nuk provohet mundësia financiare për krijimin e këtyre likuiditeteve dhe mbulimin e shpenzimeve të jetesës.

48. Në vijim, vlera prej 5.200.000 lekësh, sikundër pasuritë, likuiditetet *cash* dhe në bankë të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes, të cilat janë përdorur si burim krijimi për pasurinë objekt hetimi, kanë pasur si burim krijimi të ardhurat e familjes së subjektit dhe të ardhurat nga bujqësia.

49. Komisioni për sa më sipër konsideroi së pari të bëjë vlerësimin e të ardhurave nga bujqësia, duke analizuar pretendimet e subjektit lidhur me të ardhurat e përfituara nga bujqësia, të deklaruara si burim krijimi për pasuritë.

50. Lidhur me këto të ardhura, rezulton se ato janë deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratimet periodike vjetore të paraqitura në ILDKPKI, duke filluar nga viti 2007 deri në vitin 2016. Në rezultate hetimi këto të ardhura objekt hetimi nuk u morën në konsideratë, pasi për to nuk provohej realizimi faktik dhe as masa e tyre.

50.1 Fakti që familjet kanë përfituar tokë arë në zbatim të ligjit nr. 7501/1991 “Për tokën”, apo dhe shlyerjen e taksës vendore të tokës ndër vite nga njësia administrative vendore, jo domosdoshmërisht provojnë që toka është shfrytëzuar dhe ka prodhuar të ardhura. Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të krijimit të të ardhurave nga bujqësia për të dhe bashkëshorten.

51. Subjekti i rivlerësimit pas kalimit të barrës së provës ka paraqitur në Komision aktin e ekspertimit të hartuar nga eksperti kontabël, sipas të cilit pretendohet se të ardhurat nga toka për periudhën 2003 – 2016 duhet të llogariten në shumën 4,052,533 lekë.

52. Trupi gjykues vlerëson se ky akt ekspertimi vjen në kundërshtim me vetë deklaratimet e subjektit të rivlerësimit ndër vite, sipas të cilave ai ka deklaruar ½ e vlerës së pretenduar nga akti i ekspertimit, përkatësisht të ardhurat e deklaruara prej tij gjatë viteve dhe në deklaratën *Vetting* nga toka bujqësore gjatë periudhës 1992 – 2016 janë në shumën rreth 1.300.000 lekë dhe të ardhurat e bashkëshortes nga toka bujqësore gjatë viteve dhe në deklaratën *Vetting* gjatë periudhës 1992 – 2016 në shumën rreth 900.000 lekë – është mbështetur mbi hipoteza për mundësinë e prodhimit të produkteve të ndryshme bujqësore nga toka, por nuk provon llojshmërinë dhe sasinë reale të produkteve të pretenduara nga subjekti i rivlerësimit ndër vite, të cilat kanë shërbyer si burim për krijimin e të ardhurave, nuk referon nëse për prodhimin e produkteve do të ishte e nevojshme një fuqi punëtore apo kosto e prodhimit. Për arsyet e mësipërme, trupi gjykues vlerësoi se ky akt ekspertimi nuk ka vlerë provuese për pretendimet e subjektit të rivlerësimit.

53. Lidhur me të ardhurat e pretenduara të përfituara nga bujqësia, në vlerësimin e Komisionit subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë realizimin e të ardhurave të deklaruara në deklaratat periodike 2007 – 2016. Sa u pretendua nga subjekti se bashkëshortja e tij figuron si e vetëpunësuar në bujqësi për periudhat 1.1.1993 – 31.12.1998 dhe 1.9.2004 – 31.12.2011 apo se janë paguar rregullisht kontributet e taksës së tokës, trupi gjykues vlerëson se këto fakte nuk provojnë krijimin e të ardhurave të pretenduara.

54. Si rrjedhojë, Komisioni vlerësoi se të ardhurat nga bujqësia, të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratat periodike 2007 – 2016, mbeten në nivelin deklarativ, ndaj trupi gjykues arrin në konkluzionin për të mos i përfshirë të ardhurat e deklaruara si të përfituara nga bujqësia në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit.

55. Mospërfshirja e këtyre të ardhurave në analizën financiare do të rezultonte në pamundësi financiare nga ana e subjektit të rivlerësimit ndër vite për krijimin dhe shtimin e likuiditeteve në llogaritë bankare të cilat shërbyen për pagimin e çmimit të apartamentit në vitin 2015.

56. Në lidhje me pretendimin e subjektit pas prapësimeve për llogaritjen e një page minimale për periudhën, trupi gjykues vlerësoi se ky pretendim nuk mund të merret në konsideratë, pasi nuk është i bazuar në ligj.

57. Komisioni në analizën financiare vlerësoi të reduktojë shpenzimet jetike, referuar vendimit nr. 50 (JR), datë 14.10.2019, në masën 47.6 % të shpenzimeve të konsumit familjar edhe për periudhën 2000 – 2007, kohë në të cilën subjekti nuk kishte deklaruar të ardhura nga bujqësia. Në rezultatet e hetimit ishte vendosur reduktimi i këtyre shpenzimeve vetëm për periudhën kur subjekti deklaronte të ardhura nga bujqësia, respektivisht pas vitit 2007.

58. Në lidhje me gjendjen *cash*, trupi gjykues çmon se pretendimi i subjektit të rivlerësimit për marrjen në konsideratë të kursimeve *cash* të padeklaruar është i pambështetur në ligj dhe në prova.

Trupi gjykues sjell në vëmendje jurisprudencën e Kolegjit, lidhur me mungesën e deklarimit të gjendjeve *cash* në deklaratat periodike, sipas të cilave saktësia dhe mjaftueshmëria e deklarimeve për një subjekt deklarimi matet vetëm përmes deklarimeve të sakta dhe të plota.

59. Konkluzioni i mësipërm është arritur duke mbajtur në konsideratë për sa ka deklaruar subjekti në deklaratën *Vetting*: “*Nga totali i të ardhurave në shumën 19.990.890 lekë, minus shpenzimet prej 6.520.000 lekësh, minus shumën gjendje në depozitë në llogarinë e pagës dhe cash, gjithsej 963.301 lekë, mbeten 12.502.500 lekë. Kjo shumë dhe të ardhurat e bashkëshortes prej 1.562.586 lekësh, gjithsej rreth 14.065.000 lekë shpenzuar për familjen, shpenzime të përditshme*”.

60. Në lidhje me gjendjen *cash*, subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin në bazë të ligjit nr. 9049/2003 për të pasqyruar çdo ndryshim të gjendjes *cash* në çdo deklarim periodik në gjendjen që ishte në 31 dhjetor të vitit të mëparshëm.

61. Neni 4 parashikon: “*Subjektet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji detyrohen të deklarojnë gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të pasurive, burimet e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare, vlerën e likuiditeteve, gjendje në cash, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj*”.

62. Gjendja e likuiditeteve *cash* apo kursimet e shtuara për periudhën 2003 – 2016 nuk mund të provohen ndryshe, përveçse me deklaratat periodike, si i vetmi dokument i krijuar në kohën që pretendohet krijimi i kësaj pasurie, që mund ta provojë atë¹.

63. Pasi Komisioni vlerësoi qëndrimin e subjektit, së bashku me dokumentacionin e paraqitur prej tij në cilësinë e provave, në raport edhe me dokumentacionin e administruar gjatë hetimit administrativ, çmon se subjekti rezulton në pamundësi financiare për krijimin e likuiditeteve *cash*, shtimin e likuiditeteve në bankë dhe mbulimin e shpenzimeve të kryera ndër vite.

64. Në funksion të kryerjes së një procesi të rregullt, që garanton të drejtat e palës dhe në zbatim të parimit të proporcionalitetit dhe objektivitetit, trupi gjykues vlerësoi se edhe nëse do të konsideronte në analizën përfundimtare financiare të kryer skenarin më favorizues e garantues për subjektin e rivlerësimit, edhe nëse do të kishte marrë në konsideratë si çmim të paguar vlerën prej 5.600.000 lekësh, subjekti i rivlerësimit përsëri do të rezultonte në pamundësi financiare për krijimin e likuiditeteve ndër vite dhe shtimin e tyre, referuar analizës së kryer për subjektin e rivlerësimit.

65. Në konkluzion, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë të kundërtën e barrës së provës lidhur me burimet financiare të krijimit të kësaj pasurie të

¹ Kolegji, vendimi nr. 9 (JR), datë 15.3.2023.

paluajtshme në vitin 2015, duke mos provuar mundësinë financiare që me të ardhura të ligjshme të mundësonte pagimin e çmimit të kësaj pasurie të paluajtshme.

66. Në përfundim, lidhur me pasurinë apartament banimi, ndodhur në Tiranë, trupi gjykues vlerëson se veprimet e subjektit për të deformuar të vërtetën lidhur me këtë pasuri, përfaqësojnë përpjekje të subjektit për të justifikuar mungesë burimesh të ligjshme dhe se këto veprime rezultojnë të shoqëruara me mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pagimin e pasurisë, për shkak se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të ardhurat e deklaruara dhe pretenduara të krijuara nga bujqësia, duke rezultuar me mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të përballuar pagimin e pasurisë objekt hetimi, në kuptim të nenit 33, pika 5, shkronjat “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016.

Lidhur me pasurinë shtëpi banimi, së bashku me truallin 400 m²

67. Subjekti në deklaratën *Vetting* ka deklaruar 4.688 m² tokë arë, 160 m² pemëtoare dhe 115 m² vresht, të ndodhura në fshatin ***, rrethi Devoll, fituar me ligjin nr. 7501, datë 19.7.1991, “Për tokën”, si dhe 4.688 m² tokë arë, 160 m² pemëtoare dhe 115 m² vresht, të ndodhura në fshatin ***, rrethi Devoll, fituar në vitin 2004 me trashëgimi nga nëna M.P, e cila e ka fituar në bazë të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991.

68. Një shtëpi banimi, së bashku me truallin 400 m² me nr. pasurie ***, e ndodhur në ***, fituar me trashëgimi nga nëna M.P.

69. Komisioni ka kërkuar informacion në lidhje me pasurinë nr. *** e llojit truall, regjistruar në vol. ***, fq. ***, me sipërfaqe totale 400 m², nga të cilat 122 m² ndërtesë ndodhur në z. k. ***, ***, Devoll, e regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit, z. Seladin Z. Pysqyli.

70. Sipas përcaktimit testamentar, nëna e subjektit ka njohur si të vetmin trashëgimtar testamentar djalin e saj, z. Seladin Z. Pysqyli, për pasurinë shtëpi banimi ndodhur në ***, me truallin 400 m² tokë bujqësore, ndodhur në ***, Devoll, sasinë e lekëve në Bankën e Kursimeve ***, si dhe çdo pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme që mund të vijë në të ardhmen nga trashëgimlënësja.

71. Subjekti, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, në lidhje me mënyrën e krijimit, vlerën e investimit dhe burimin financiar të krijimit të kësaj pasurie ka shpjeguar se: *“Toka është blerë me kontratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 10.3.1997, kundrejt çmimit prej 200.000 lekësh dhe me vendimin nr. *** të KRRT-së Devoll është miratuar leja e ndërtimit. Po kështu, për ndërtimin e shtëpisë janë përdorur të ardhurat nga shitja e bagëtive që kishte familja dhe, ashtu siç kam deklaruar, kam kontribuar edhe unë nga të ardhurat e mia, pasi jetonim së bashku”*.

72. Lidhur me ndërtimin e pasurisë shtëpi banimi, e deklaruar si e ndërtuar edhe me kontributin e subjektit, u krye analiza financiare për krijimin e kësaj pasurie sipas dokumentacionit të administruar dhe deklarimit nga subjekti i rivlerësimit.

73. Nga analiza financiare rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe familjarët e tij kanë qenë në pamundësi financiare në shumën -1.520.389 lekë për blerjen e tokës sipas kontratës noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 10.3.1997 + koston e ndërtimit të banesës sipas koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave në vitin 1997 dhe kryerjen e shpenzimeve të tjera, nga e cila rezultoi një pamundësi financiare prej -1.520.389 lekësh.

74. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të paraqitur shpjegime/prova për të provuar të kundërtën e konstatimit të Komisionit se subjekti dhe familjarët duket se nuk provojnë burimet e ligjshme të krijimit të pasurisë.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

75. Pas kalimit të barrës së provës, subjekti ndër të tjera ka prapësuar si vijon:

“Në lidhje me llogaritjen e kostos së banesës, nuk jam dakord dhe e kundërshtoj për sa më poshtë. Në lidhje me koston e ndërtimit të shtëpisë, nuk jam aspak dakord me vlerësimin e bërë, pasi ashtu siç kam shpjeguar, kostoja reale e ndërtimit ka shkuar rreth 500,000 lekë, pasi të gjitha materialet e ndërtimit, si gurë, tulla e lëndë drusore kanë qenë të familjes, nga objektet e fituara nga shpërbërja e ish-kooperativës”.

76. Subjekti gjithashtu kërkoi korrigjimin e të ardhurave sipas vërtetimit të zyrës së financës; të ardhurat neto për periudhën qershor 1995 – dhjetor 1997 janë llogaritur 311,771 lekë më pak. Për vitet 1991 – 1992 nuk është llogaritur sa ka fituar prej vitit 1985 nga puna në ish-kooperativën bujqësore ***, Tropojë dhe, pasi është transferuar në datën 10.7.1990, në ish-kooperativën bujqësore ***, Devoll, për 22 muaj paga ka qenë 92,224 lekë.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

77. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës dhe deklaratimet në seancën dëgjimore – arsyeton se:

78. Komisioni, pasi vlerësoi qëndrimin e subjektit së bashku me dokumentacionin e paraqitur prej tij në cilësinë e provave, në raport edhe me dokumentacionin e administruar gjatë hetimit administrativ, çmon që të merren në konsideratë të ardhurat e subjektit të rivlerësimit për periudhën 1993 – 1998 sipas dokumentacionit të përcjellë nga subjekti i rivlerësimit në prapësime, si dhe dorëzuar në seancën dëgjimore, sipas së cilës janë rillogaritur të ardhurat për periudhën dhjetor 1993 – maj 1995 si ndihmësgjyqtar dhe gjatë periudhës qershor 1995 – dhjetor 1998 si gjyqtar.

79. Në lidhje me të ardhurat e përfituara për periudhën 1985 –1992, për të cilat subjekti i rivlerësimit pretendon përfshirjen në analizë, Komisioni çmon se bazuar në jurisprudencën e Kolegjit² periudha kohore para viteve 1991 – 1992 nuk mund të jetë si rregull një periudhë e cila mund të llogaritet në funksion të përcaktimit të ndonjë vlere të kursyer, për shkak të një realiteti të jetuar, që ka provuar se monedha zyrtare, leku, në këtë periudhë pësoi një inflacion në nivele shumë të larta e të jashtëzakonshme, produkt i ndryshimeve politike, sociale dhe ekonomike në vend, që e bën të pabesueshme dhe të palogjikshme mundësinë potenciale të kursimit nga të ardhurat nga puna në këto periudha.

80. Pasi vlerësoi pretendimet e subjektit lidhur me të ardhurat e përfituara nga bujqësia, Komisioni vlerëson se ato nuk mund të merren në konsideratë, pasi nuk provohet realizimi faktik dhe as masa e tyre. Në vijim të shqyrtimit të pretendimeve të subjektit, Komisioni kreu analizën përfundimtare lidhur me këtë pasuri, duke zbritur koston e EKB-së, TVSH-në (tatim mbi vlerën e shtuar) + fitim + fond rezervë³, për sa pretendimi i subjektit se *“kostoja reale e ndërtimit ka shkuar rreth 500,000*

² Vendimi nr. 15/2021 (JR), subjekti K. Selita.

³ Në lidhje me koston e ndërtimit, Komisioni çmon të konsiderojë në analizë hipotetikiisht si kosto vlerën e dalë duke zbritur nga çmimi për metër katror, sipas koston së përcaktuar prej Entit Kombëtar të Banësive, shumatoren e vlerave që përfaqësojnë TVSH + fitim + fond rezervë, e cila është përlllogaritur në vlerën 35%, referuar jurisprudencës së Kolegjit, vendimi nr. 15/2019.

lekë”, ngeli i paprovuar dhe vetëm deklarativ, si dhe korrigoji të ardhurat e subjektit të rivlerësimit sipas vërtetimit përkatës të ardhurat e subjektit të rivlerësimit për periudhën 1993 – 1998 sipas dokumentacionit të përcjellë nga subjekti i rivlerësimit në prapësime, si dhe dorëzuar në seancën dëgjimore, sipas së cilës janë rillogaritur të ardhurat për periudhën dhjetor 1993 – maj 1995 si ndihmësgjyqtar dhe gjatë periudhës qershor 1995 – dhjetor 1998 si gjyqtar, ku në përfundim analiza financiare e subjektit të rivlerësimit dhe familjarëve të tij për ndërtimin e kësaj banese rezultoi në pamundësi financiare në shumën -821.700 lekë, sipas tabelës.

Periudha	1993 – 1997
Të ardhurat	906 754
Të ardhurat neto nga marrëdhëniet e punësimit të subjektit për periudhën 1993 – 1997	802 173
Të ardhura neto nga marrëdhënie e punësimit të bashkëshortes, për periudhën 1993 – 1997	52 081
Të ardhura bashkëshortja nga vetëpunësimi në bujqësi 1993 – 1997	0
Të ardhura nga pensioni nëna e subjektit të rivlerësimit, për periudhën 1993 – 1997	52 500
Shpenzime	398 429
Shpenzime jetike për periudhën 1993 – 1997	398 429
Pasuri	1 330 025
Truall 400 m ² + shtëpi banimi në *** sipas EKB-së së vitit 1997	1 330 025
Rezultati Financiar	-821.700

81. Në përfundim, Komisioni arriti në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit dhe familjarët nuk kanë arritur të provojnë mundësinë financiare të krijimit të pasurisë gjatë kohës që subjekti ushtronte funksionin, pasuri e deklaruar në pronësi të subjektit në deklaratën *Vetting*, duke u ndodhur në kushtet e parashikuara nga neni 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

ANALIZA FINANCIARE

82. Komisioni, bazuar në të dhënat e administruara gjatë hetimit për vlerësimin e pasurisë së subjektit Seladin Pysqyli, hartoi analizën financiare. Nga analiza financiare duket se subjekti dhe personat e lidhur kishin një pamundësi financiare totale prej -6,324,820 lekësh për periudhën 1993 – 2016.

83. Për sa më sipër, subjektit të rivlerësimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i kaloi barra e provës për të dhënë argumentet dhe paraqitur provat e saj për të provuar të kundërtën e konstatimeve të bëra nga ana e Komisionit lidhur me analizën financiare.

84. Pas marrjes së shpjegimeve dhe provave të subjektit të rivlerësimit, Komisioni vlerësoi të pasqyrojë në analizën financiare si vijon:

- Ka zbritur shpenzimet për udhëtimet e subjektit për trajnime në vitet 2013 – 2015, si të provuara nga subjekti pas kalimit të barrës së provës.
- Ka zbritur shpenzimet jetike për periudhën 2000 – 2016 në masën 47.6%.
- Ka marrë në konsideratë të ardhurat e subjektit të rivlerësimit për periudhën 1993 – 1998 sipas dokumentacionit të përcjellë nga subjekti i rivlerësimit në prapësime, rillogaritur të ardhurat për periudhën dhjetor 1993 – maj 1995 si ndihmësgjyqtar dhe qershor 1995 – dhjetor 1998 si gjyqtar.
- Ka reduktuar koston e ndërtimit për banesën në ***, në vitin 1997, duke zbritur koston e EKB-së, TVSH-në (tatim mbi vlerën e shtuar) + fitim + fond rezervë⁴, pasi pretendimi i subjektit se “*Kostoja reale e ndërtimit ka shkuar rreth 500,000 lekë*”, mbeti i paprovuar.

⁴ Në lidhje me koston e ndërtimit, Komisioni ka konsideruar në analizë, si kosto ndërtimi, vlerën e llogaritur referuar jurisprudencës së Kolegjtit, në vendimin nr. 15/2019.

- e) Ka marrë në konsideratë versionin më favorizues, duke llogaritur si çmim të paguar vlerën prej 5.600.000 lekë, për pasurinë apartament banimi, ndodhur në Tiranë.

Nga analiza përfundimtare financiare e viteve 1993 – 2002, subjekti i rivlerësimit rezulton në pamundësi financiare në shumën -437.726 lekë.

Nga analiza përfundimtare financiare 2003 – 2016, subjekti i rivlerësimit rezulton në pamundësi financiare në shumën -3.209.388 lekë.

85. Në përfundim, trupi gjykues arriti në konkluzionin se si pasojë e mungesës së burimeve të ligjshme për të justifikuar shpenzimet e kryera, në vlerën totale prej -3.209.388 lekë lekësh, për vitet 2003 – 2016 dhe - 437.726 lekë për vitet 1993 – 2002, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të ndodhen në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm, në kuptim të pikave 1 dhe 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 30 dhe 33 të ligjit nr. 84/2016.

Konkluzioni i Komisionit lidhur me kriterin e pasurisë

86. Në përfundim të analizës financiare të kryer nga Komisioni për verifikimin e mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme, trupi gjykues arriti në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të ndodhen në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për të justifikuar shpenzimet e kryera dhe pasuritë e krijuara në kuptim të pikave 1 dhe 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe të neneve 30 dhe 33 të ligjit nr. 84/2016.

87. Në rastin konkret, pamjaftueshmëria financiare për krijimin e pasurive dhe mbulimin e shpenzimeve të subjektit dhe personave të lidhur me të, e konsideruar së bashku me përpjekjen e subjektit për të deformuar të vërtetën në funksion të paraqitjes së të dhënave lidhur me pasurinë e ndodhur në Tiranë, çojnë trupin gjykues në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e deklarimit të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, lidhur me kriterin e pasurisë sipas parashikimeve të nenit 33, pika 5, shkronja “b” dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

Seladin Pysqyli	Rezultati negativ													3,647,113				
Gjykata e Rrethit Gjiqësor Korçë	akum 1999-2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016			
PASURI	2,519,871	1,189,846	362,989	90,197	634,116	1,220,225	-42,013	759,108	637,973	917,429	913,324	1,250,268	1,143,392	-3,805	1,093,690			
Toke are 4688 m2, 160 m2 pemtore dhe 115 m2 vresht ne fshatin ***, ligji 7501 date 19.07.1991-SR 100%	0																	
Toke are 4688 m2, 160 m2 pemtore dhe 115 m2 vresht ne fshatin ***, trashegimi nga nena M.P. ne v.2004	0																	
Shtepi banimi+truall 400 m2 ne ***, trashegimi nga nena M.P	0																	
Autoveture *****, targa DV***A, kontr. Nr. *** Rep., nr. *** Kol, date 21.07.2006	0				400,000													
Autoveture *****, targa DV***A, kontr. Nr. *** rep., nr. *** kol, date 28.02.2007	0					420,000												
Autoveture *****, targa DV***A, komrk 2010	0								637,739									
Toke are 4683 m2, 160 m2 pemtore dhe 115 m2 vresht ne fshatin ***, ligji 7501 date 19.07.1991-b/shortja 100%	0																	
Toke are 1561 m2, 53 m2 pemtore dhe 38 m2 vresht ne fshatin ***, trashegimi nga babai S.H-b/shortja 100%	0																	
Toke are 4683 m2, 160 m2 pemtore dhe 115 m2 vresht ne fshatin ***, trashegimi nga nena A.H-b/shortja 100%	0																	
Shtepi banimi me sip. Nderimore 89 m2 dhe truall 300 m2, ne fshatin ***- b/shortja me 2/3 pjese	0																	
Apartment banimi ne ***, kontr. Sipermarjes dt. 04.01.2014 dhe kontr. Nr. *** Rep., Nr. *** Kol., date 09.03.2015	0												280,000	4,920,000				
Shtepi banimi me sip. 122 m2 +toke ne ***, kontr. Nr. *** rep., nr. *** kol., date 10/03,1997	1,330,025																	
Ndryshim Likuiditete	1,189,846	1,189,846	362,989	90,197	234,116	800,225	-42,013	759,108	234	917,429	913,324	1,250,268	863,392	-4,923,805	1,093,690			
Likuiditete total	1,189,846	1,189,846	1,552,835	1,643,032	1,877,148	2,677,372	2,635,359	3,394,467	3,394,700	4,312,129	5,225,453	6,475,721	7,339,113	2,415,308	3,508,998			
DETYRME	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
PASURI NETO	2,519,871	1,189,846	362,989	90,197	634,116	1,220,225	-42,013	759,108	637,973	917,429	913,324	1,250,268	1,143,392	-3,805	1,093,690			
TE ARDHURA	3,765,228	733,272	838,304	878,770	1,298,160	823,674	787,582	1,225,369	1,385,198	1,029,115	1,545,860	1,164,855	1,483,490	1,418,525	1,385,915			
Te ardhura nga paga+shperblime SR 1993-2016	2,821,683	599,530	790,254	814,714	845,705	747,314	786,267	982,444	1,004,048	1,014,559	1,047,340	1,086,775	1,397,206	1,369,940	1,385,915			
Te ardhura nga paga b/Shortja 1997-2004	548,546	123,242	41,050	0														
Te ardhura nga interesat e depozitave				64,056	52,455	76,360	1,315	242,925	15,525	14,556	498,520	12,455	86,284	48,585				
Te ardhura nga demshperblimi i ish te denuarve politike 2010 & 2013	0								65,625			65,625						
Te ardhura nga pensioni nena e SR 1993-2004	105,000	10,500	7,000															
Te ardhura nga toka bujqesore b/shortja 2008-2016								400,000	400,000	450,000	450,000	0	0	0	0			
Te ardhura nga shitje autoveture Ford ne v.2006	0				400,000													
Te ardhura nga shitje autoveture *** ne v.2010	0								300,000									
Mundespi per kursim 1993-1996																		
Te ardhura nga shitje e pasurise truall 286 m2+ndertese 40 m2 shtepi banimi nga nena e SR ne v.2002	290,000																	
SHPENZIME	1,683,083	336,332	336,332	397,610	385,356	513,718	405,013	398,853	414,241	544,446	444,249	410,392	590,406	816,327	619,565			
Shpenzime jetese sipas ILDKPKI	1,683,083	295,423	295,423	344,447	344,447	357,944	357,944	357,944	357,944	357,944	365,616	369,483	576,395	352,562	369,565			
Shpenzime udhetimi TMS	0			12,254	0	114,865	6,159	0	15,388	145,593	37,724	0	14,011	13,765	0			
Shpenzim per pagese gjobe administrative sipas vendimit nr.5 date 07.01.2015 te ILDKPKI-se	0														200,000			
Shpenzime mobilimi per shtepine e nenes se SR 2003-2013	0	40,909	40,909	40,909	40,909	40,909	40,909	40,909	40,909	40,909	40,909	40,909						
Shpenzime per femijet te ndare nga cert.familijare 2015-2016	0														250,000	250,000		
Analiza dokumentuar	-437,726	-792,906	138,983	390,963	278,688	-910,269	424,583	67,408	332,984	-432,760	188,286	-495,805	-250,308	606,003	-327,340			

B. KONTROLI I FIGURËS

88. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (ish-DSIK), si institucioni kompetent për kontrollin e figurës, verifikimit të deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, në përmbushje të ushtrimit të funksioneve sipas ligjit nr. 8457, datë 11.2.1999, i ndryshuar, si dhe në përputhje me kërkesat e nenit 39, pika 2 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka paraqitur pranë Komisionit raportin, me konstatimin për përshtatshmëri në vazhdimin e detyrës.

89. Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvleftësimit të Informacionit të Klasifikuar në Autoritetin Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar, me vendimin nr. **, datë 29.2.2024, ka vendosur të deklasifikojë plotësisht raportin, për subjektin e rivlerësimit Seladin Z. Pysqyli.

90. Bazuar në informacionet e ardhura nga institucionet verifikuese në kohështrirje gjatë periudhës së rivlerësimit, rezulton se:

91. Për subjektin e rivlerësimit Seladin Z. Pysqyli nuk administrohen informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për përfshirje në veprimtari të paligjshme.

Konkluzioni i Komisionit për kontrollin e figurës

92. Në përfundim të procesit të rivlerësimit të figurës, bazuar në nenin DH të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklaramit për kontrollin e figurës dhe nuk u gjet asnjë element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar.

93. Komisioni arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

94. Vlerësimi i aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit është kryer në bazë të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, kreut VI, nenet 40 e vijues të tij, si dhe mbi bazën e kriterëve përcaktuara në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nga organi kompetent, Këshilli i Lartë Gjyqësor.

95. Raporti për analizën e aftësive profesionale, kryer nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, është bazuar në formularin e vetëdeklarimit bashkë me dokumentet shoqëruese, tri dokumentet ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, pesë dosjet gjyqësore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor dhe të dhënat nga burimet arkivore të KLGJ-së. Subjekti i rivlerësimit Seladin Pysqyli ka përzgjedhur dhe ka paraqitur tri dokumente ligjore, si vijon:

Dokumenti 1. Vendimi penal nr. ***, datë 18.5.2016, që i përket të pandehurit K.P, i akuzuar për kryerjen e veprës penale “Mashtrimi”, parashikuar nga neni 143/1 i Kodit Penal.

Çështja është gjykuar në seancë gjyqësore publike me trup gjykues të përbërë vetëm nga subjekti i rivlerësimit. Seanca është zhvilluar në datën 18.5.2016 dhe vendimi është dhënë në datën 18.5.2015. Në përfundim është vendosur deklarimi fajtor i të pandehurit K.P për veprën penale të parashikuar nga neni 143/1 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 6 muaj burgim. Në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale dënohet përfundimisht me 4 muaj burgim.

Kundër këtij vendimi është ushtruar ankim dhe Gjykata e Apelit Korçë, me vendimin nr. ***, datë 11.10.2016, ka vendosur “Lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 18.5.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë”.

Çështja është regjistruar për gjykim në datën 18.4.2016 dhe vendimi është dhënë në datën 18.5.2016. Gjykimi ka zgjatur 1 muaj. Ky gjykim është brenda afatit 9-mujor të caktuar nga pika 5, shkronja “a” e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit.

Vendimi përmban strukturën e përcaktuar dhe është i ndarë në pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe në dispozitivin e gjykatës. Në pjesën hyrëse të vendimit janë përshkruar palët, të dhëna për përfaqësimin e pjesëmarrjen e tyre në gjykim, akuza, si dhe kërkimet përfundimtare të palëve. Pjesa përshkruese-arsyetuese “Vëren” është strukturuar me paragrafë të filluar me kryeradhë dhe fillon me kërkesën e paraqitur nga prokurori për gjykimin e të pandehurit dhe akuza përkatëse. Ka analizuar juridiksionin dhe kompetencën e saj në gjykimin e çështjes dhe bazuar në nenet 69/1, 74 dhe 76/1 të Kodit të Procedurës Penale ka konstatuar se çështja hyn në juridiksionin gjyqësor dhe është në kompetencën lëndore e tokësore të kësaj gjykate. Me paragraf më vete ka paraqitur kërkesën e të pandehurit, bazuar në nenin 403 të Kodit të Procedurës Penale për gjykim të shkurtuar, e cila nuk u kundërshtua nga organi i akuzës, si dhe pranimin e kërkesës nga gjykata, pasi vlerësoi se

çështja mund të zgjidhej në gjendjen që janë aktet, bazuar në nenin 404 të Kodit të Procedurës Penale dhe vendimin unifikues të Gjykatës së Lartë nr. 2, datë 29.1.2003. Më tej ka vijuar me parashtrimin e rezultateve të hetimit të prokurorit, duke filluar me paraqitjen e rrethanave të ngjarjes, qëndrimin pohues dhe pendues për veprën e kryer nga i pandehuri, kërkimin e mbrojtësit që gjykata të mbajë parasysh një sërë rrethanash lehtësuese, si dhe të aplikojë dënimin alternativ të parashikuar nga neni 59 i Kodit Penal. Gjykata ka paraqitur rrethanat e faktit që kanë dalë pas dëgjimit të palëve dhe aktet e marra në gjykim, duke i paraqitur mjaft të detajuara dhe ka vlerësuar se i pandehuri ka konsumuar elementet e veprës penale të mashtrimit dhe duhet të deklarohet fajtor. Ka analizuar katër elementet e figurës së veprës penale, ka çmuar se kualifikimi ligjor i veprës është bërë drejt nga prokurori dhe, në referim të vendimit unifikues të Gjykatës së Lartë nr. 5, datë 11.11.2003, ka çmuar se nga vepra nuk kanë ardhur pasoja të rënda. Gjykata ka renditur rrethanat që do të mbahen parasysh në caktimin e llojit dhe masës së dënimit dhe në përfundim ka çmuar se i pandehuri duhet të deklarohet fajtor e të dënohet me 1 vit burgim dhe, në aplikim të nenit 51 të Kodit Penal, të dënohet me 6 muaj burgim. Për shkak të gjykimit të shkurtuar aplikohet neni 406/1 i Kodit Penal dhe dënohet përfundimisht me 4 muaj burgim. Gjykata ka argumentuar përse e gjen të pabazuar kërkesën e mbrojtësit për aplikimin e nenit 59 ose 63 të Kodit Penal. Në dispozitivin e vendimit, gjykata është shprehur, përveç deklarimit fajtor e masën e dënimit, për fillimin e vendin e vuajtjes së dënimit, për shpenzimet procedurale të hetimit paraprak dhe shpenzimet gjyqësore, si dhe të drejtën e ankimit ndaj vendimit.

Dokumenti 2. Vendimi civil nr. ***, datë 16.9.2015, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, i përket palës paditëse, shoqërisë “****” sh.p.k., me të paditur ***, person i tretë ***, me objekt “Ndryshimin e vendimit, duke u kthyer ish-pronarëve sipërfaqen e lirë dhe duke e kompensuar për sipërfaqen e zënë”. Në përfundim është vendosur rrëzimi i padisë.

Çështja është regjistruar për gjykim në datën 17.3.2015 dhe vendimi është dhënë në datën 16.9.2015. Gjykimi ka zgjatur 5 muaj e 29 ditë. Ky afat është brenda afatit 6-mujor të caktuar nga pika 5, shkronja “e” e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit.

Vendimi përmban strukturën e përcaktuar dhe është i ndarë në pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe në dispozitivin e gjykatës. Në pjesën hyrëse të vendimit janë përshkruar trupi gjykues, palët duke specifikuar të dhëna për përfaqësimin dhe pjesëmarrjen e tyre në gjykim, objekti dhe baza ligjore e padisë, si dhe kërkimet përfundimtare të palëve. Pjesa arsyetuese është strukturuar me paragrafë të filluar me kryeradhë e pa ndonjë ndarje tjetër. Fillon me paraqitjen e kërimit të paditësit. Gjykata kryesisht, bazuar në nenin 36/1 e 45 të Kodit të Procedurës Civile, ka konstatuar se çështja bën pjesë në juridiksionin gjyqësor dhe është në kompetencën lëndore e tokësore të saj. Gjithashtu, bazuar në vendimin unifikues të Gjykatës së Lartë nr. 04, datë 10.12.2013, ka çmuar se çështja hyn në juridiksionin gjyqësor dhe jo atë administrativ. Më tej ka vijuar me çfarë ka rezultuar gjatë shqyrtimit gjyqësor lidhur me rrethanat e faktit, ka pasqyruar marrëdhënien juridike të krijuar mes palëve ndërgjyqëse dhe konfliktin e krijuar për shkak të mosqenies dakord me vendimet e palës së paditur, çka e ka detyruar paditësin të ngrejë padi për ndryshimin e tyre. Ka analizuar bazuar në nenin 32/a të Kodit të Procedurës Civile legjitimitetin e palëve. Ka paraqitur se nisur nga natyra e mosmarrëveshjes mbi kërkesën e palëve, bazuar në nenin 224/a të Kodit të Procedurës Civile, vendosi kryerjen e ekspertimit teknik dhe ka përmbledhur mendimin e ekspertit. Gjykata, pas dëgjimit të pretendimeve të palëve dhe analizimit të provave, ka çmuar se padia duhet të rrëzohet si e pabazuar, pasi ka vlerësuar se është para parimit të gjësë së gjykuar dhe ka dhënë argumentet përkatëse, bazuar në nenin 451/a të Kodit të Procedurës Civile, duke analizuar se shkak i ngritjes së padisë është i njëjtë, objekti i padisë është i njëjtë dhe palët ndërgjyqëse janë të njëjta. Ka paraqitur pretendimin e personit të tretë e palës paditëse se nuk jemi para gjësë së gjykuar dhe paraqitur me paragrafë të numërtuar nga 1-4 arsyet që ky pretendim është i pabazuar. Në lidhje me shpenzimet

gjqësore, bazuar në nenin 106 të Kodit të Procedurës Civile, gjykata në kushtet e rrëzimit të padisë ka çmuar se ato i mbeten palës paditëse dhe, meqenëse palët nuk kanë detyrime reciproke, çmohet se nuk është rasti për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit. Gjkata në dispozitiv ka vendosur rrëzimin e padisë dhe për të drejtën e afatin e ankimit edhe për palët në mungesë.

Dokumenti 3. Vendimi civil nr. ***, datë 21.9.2015, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, që i përket paditësit S.Th, me të paditur ***, persona të tretë ***, me objekt “Ndryshimin e vendimit duke u njohur pronësia dhe duke iu kthyer trashëgimtarëve një sipërfaqe prej 442.4 ha kullotë”. Në përfundim është vendosur rrëzimi i padisë.

Kundër vendimit është ushtuar ankim dhe Gjykata e Apelit Korçë, me vendimin nr. ***, datë 24.3.2016, ka vendosur “Lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 21.9.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë”.

Çështja është regjistruar për gjykim në datën 15.1.2015 dhe vendimi është dhënë në datën 21.9.2015. Gjykimi ka zgjatur 8 muaj e 6 ditë. Ky afat është jashtë afatit 6-mujor të caktuar nga pika 5, shkronja “e” e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit.

Vendimi përmban strukturën e përcaktuar dhe është i ndarë në pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe në dispozitivin e gjykatës. Në pjesën hyrëse të vendimit janë përshkruar trupi gjykues, palët, objekti dhe baza ligjore e padisë, si dhe kërkimet përfundimtare të palëve. Pjesa arsyetuese është e strukturuar. Fillon me paraqitjen e objektit të padisë. Gjykata kryesisht, bazuar në nenet 36/1 e 45/1 të Kodit të Procedurës Civile, ka konstatuar se çështja bën pjesë në juridiksionin gjyqësor dhe është në kompetencën lëndore e tokësore të saj. Gjithashtu, bazuar në vendimin unifikues të Gjykatës së Lartë nr. 04, datë 10.12.2013, ka çmuar se çështja hyn në juridiksionin gjyqësor dhe jo atë administrativ. Më tej, ka vijuar me çfarë ka rezultuar gjatë shqyrtimit gjyqësor lidhur me rrethanat e faktit, ka pasqyruar marrëdhënien juridike të krijuar mes palëve ndërgjyqëse dhe konfliktin e krijuar për shkak të mosqenies dakord me vendimin e palës së paditur, çka e ka detyruar paditësin të ngrejë padi për ndryshimin e tij. Ka paraqitur se nisur nga natyra e mosmarrëveshjes mbi kërkesën e palëve, bazuar në nenin 224/a të Kodit të Procedurës Civile, vendosi kryerjen e ekspertimit teknik dhe ka paraqitur mendimin e ekspertit. Ka analizuar bazuar në nenin 32/a të Kodit të Procedurës Civile legjitimitetin e palëve. Gjykata, pas dëgjimit të pretendimeve të palëve dhe analizimit të provave, ka çmuar se padia duhet të rrëzohet si e pabazuar në prova dhe në ligj. Gjykata fillimisht ka analizuar nëse jemi para parimit të gjësë së gjykuar dhe, referuar provave të marra në gjykim, shkakut dhe objektit të padisë, bazuar në nenin 451/a të Kodit të Procedurës Civile, ka çmuar se nuk jemi para këtij parimi. Gjykata në dispozitiv ka vendosur rrëzimin e padisë dhe është shprehur lidhur me shpenzimet gjyqësore, si dhe për të drejtën e afatin e ankimit edhe për palët në mungesë.

Të tria vendimet paraqiten të standardizuara në drejtim të organizimit formal dhe të strukturës.

PËRSHKRIMI I 5 DOSJEVE GJYQËSORE TË PËRZGJEDHURA ME SHORT

Dosja 1. Çështja civile nr. *** regj., datë 30.6.2014, që i përket paditësit H.B, me të paditur *** sh.a., me objekt “Dëmshpërblim nga marrëdhëniet e punës”, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 8.10.2014.

Çështja është regjistruar në datën 30.6.2014 dhe në shortin e po kësaj date kjo çështje i është caktuar për gjykim gjyqtarit Seladin Pysqyli. Rezulton nga aktet në dosje se me vendimin e datës 1.7.2014 (1 ditë nga shorti) gjyqtari ka caktuar seancën përgatitore më 17.7.2014, ora 09:00, bazuar në nenin 158/a të Kodit të Procedurës Civile. Janë zhvilluar 5 seanca gjyqësore. Në seancën gjyqësore të datës 8.10.2014, gjykata, pasi dëgjoi pretendimet përfundimtare të palëve, vendosi pranimin e padisë, duke e paraqitur të plotë dispozitivin e vendimit. Gjykata, bazuar në nenet 310/1, 510/a, 511/a e 511/1 të

Kodit të Procedurës Civile, ka vendosur lëshimin e urdhrit të ekzekutimit për titullin ekzekutiv vendimi nr. ***, datë 8.10.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë. Në dispozitivin e urdhrit nuk është treguar zyra e përmbarimit shtetëror ose privat si subjekti që ngarkohet për ekzekutimin e detyrueshëm të këtij vendimi dhe as fakti që urdhri i ekzekutimit lëshohet vetëm në një kopje.

Ndaj vendimit është paraqitur ankim dhe Gjykata e Apelit Korçë me vendimin nr. ***, datë 2.4.2015, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 8.10.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, që u përket palëve H.B e *** sh.a.

Dosja gjyqësore, së bashku me vendimin e arsyetuar, janë depozituar nga gjyqtari Seladin Pysqyli në kryesekretari në datën 10.10.2014, pas 2 ditëve nga shpallja, brenda afatit procedural civil 10-ditor të parashikuar në nenin 308 të Kodit të Procedurës Civile.

Gjykimi nga subjekti i rivlerësimit Seladin Pysqyli ka zgjatur gjithsej 3 muaj e 8 ditë, në intervalin kohor 30.6.2014 – 8.10.2014. Kjo kohëzgjatje është brenda afatit 6-mujor të caktuar nga pika 5, shkronja “e” e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit.

Dokumentacioni në dosjen e vëzhguar është i rregullt dhe aktet e krijuara apo të vlerësuara nga subjekti janë të sakta nga ana formale. Në dosje gjendet kërkesëpapia, vendimi për caktimin e seancës përgatitore, aktet e njoftimit të palëve, provat e paraqitura nga palët ndërgjyqëse, procesverbalet e seancave gjyqësore, konkluzionet përfundimtare të palëve dhe vendimet gjyqësore. Vendimi për kalimin e çështjes në gjykim nuk është i veçantë, por pasqyrohet në procesverbalin e seancës përgatitore. Veprimet e kryera në seancat gjyqësore të mësipërme janë dokumentuar në procesverbalet përkatëse, të cilat janë të rregullta nga pikëpamja formale dhe janë mbajtur sipas parashikimeve të neneve 118 dhe 158/a të Kodit të Procedurës Civile. Procesverbalet e seancave gjyqësore janë firmosur rregullisht. Procesverbalet e seancave përgatitore dhe gjyqësore janë mbajtur dhe dokumentuar me regjistrim audio. Dosja është sistemuar në mënyrë kronologjike në referencë të rregullave procedurale civile, duke u bërë lehtësisht e shfrytëzueshme për palët. Aktet në dosje janë të inventarizuara rregullisht.

Vendimi përmban elementet e parashikuara në nenin 310 të Kodit të Procedurës Civile dhe është i ndarë në pjesën hyrëse, pjesën përshkuese-arsyetuese dhe pjesën dispozitive të gjykatës. Në pjesën hyrëse të vendimit janë përshkruar trupi gjykues, palët duke specifikuar të dhëna për përfaqësimin e tyre në gjykim, objekti e baza ligjore e padisë dhe kërkimet përfundimtare të palëve. Pjesa arsyetuese është strukturuar me paragrafë të nisur me kryeradhë e pa ndonjë ndarje tjetër. Fillon me paraqitjen e plotë të objektit të padisë. Gjykata kryesisht, bazuar në nenet 36/1, 47/1 e 54 të Kodit të Procedurës Civile e nenin 7 të Kodit të Punës, arrin në përfundimin së çështja bën pjesë në juridiksionin gjyqësor dhe është në kompetencën lëndore e tokësore të saj. Ka analizuar bazuar në parashikimet e ligjit nr. 49/2012, datë 3.5.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, se kjo mosmarrëveshje nuk është në kompetencën e gjykatës administrative, pasi bazuar në nenin 7/ç të ligjit gjykata administrative gjykon mosmarrëveshjet e punës kur punëdhënësi është organ i administratës publike. Ka paraqitur në mënyrë të plotë pikën 6 të nenit 3 të ligjit, i cili përcakton se cili është organ publik. Punëdhënësi në rastin në gjykim është shoqëri tregtare dhe veprimtaria e saj rregullohet nga ligji nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i cili nuk parashikon që shoqëritë tregtare të kryejnë funksione publike. Ka parashtruar pretendimet e paditësit dhe palës së paditur dhe ka çmuar se konflikti midis palëve rrjedh nga marrëdhëniet e punës dhe kuadri ligjor i zbatueshëm janë dispozitat e Kodit të Punës dhe se paditësi ka legjitimitetin për këtë kërkim. Gjykata është shprehur për të gjitha kërkimet, duke nisur me kërkimin për pagën e 1 viti, për shkak të zgjidhjes së menjëhershme dhe pa shkaqe të arsyeshme të kontratës së punës, kërkimin për dëmshpërblimin për moszbatim të procedurës ligjore për

zgjdhjen e kontratës së punës, si dhe kërkimin për dëmshpërblimin për vjetërsinë në punë. Bazuar në vendimin unifikues të Gjykatës së Lartë, në nenin 155 të Kodit të Punës në përcaktimin e masës së dëmshpërblimit, gjykata ka pasur parasysh kohëzgjatjen e marrëdhënies së punës, moshën e paditësit, e cila nuk e favorizon atë për të gjetur punë tjetër dhe ka çmuar të dëmshpërblehet në masën e 6 pagave mujore. Gjykata ka vlerësuar se pala e paditur nuk e ka respektuar procedurën e zgjidhjes së kontratës së punës dhe pretendimi i paditësit është i bazuar në ligj e në prova dhe duhet pranuar. Gjithashtu, gjykata, bazuar në nenin 145 të Kodit të Punës, ka vlerësuar se plotësohen kushtet që paditësi të përfitojë shpërblimin për vjetërsi në punë, duke u dëmshpërblyer me 3 paga mujore. Gjykata masën e pagës ka vlerësuar të jetë paga në momentin e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës. Është shprehur për shpenzimet gjyqësore, të cilat i ngarkohen palës së paditur dhe, meqenëse ka detyrime në lekë, ka çmuar se duhet të lëshohet urdhri i ekzekutimit. Pjesa e tretë dispozitivi i gjykatës, nga pikëpamja formale është në përputhje me nenin 310, pika 3 e Kodit të Procedurës Civile. Aty është disponuar për pranimin e padisë e disponimet respektive, si dhe për shpenzimet gjyqësore. Tregohet e drejta dhe afati i ankimit ndaj vendimit për palët në proces.

Dosja 2. Çështja civile nr. *** regj., datë 2.10.2014, që i përket paditësit T.K, kundër të paditurit ***, me objekt “Njohjen pjesërisht të pavërtetë të të dhënave të pasqyruara në regjistrin themeltar nr. ***, fleta ***, të ish-kooperativës *** në lidhje me atësinë dhe mbiemrin”, e përfunduar me vendimin nr. *** datë 17.11.2014.

Çështja është regjistruar në datën 2.10.2014 dhe me shortin e po kësaj date i është caktuar për gjykim gjyqtari Seladin Pysqyli. Me vendimin e datës 3.10.2014 (1 ditë nga shorti), gjyqtari ka caktuar seancën përgatitore më 29.10.2014, ora 11:00, bazuar në nenin 158/a të Kodit të Procedurës Civile. Janë zhvilluar gjithsej dy seanca gjyqësore. Gjykata në seancën e dytë, bazuar në nenin 302 të Kodit të Procedurës Civile, vendos t'i japë fund hetimit gjyqësor dhe fton palët për pretendimet përfundimtare. Përfaqësuesi i paditësit ngre pretendimet me gojë dhe kërkon pranimin e padisë. Përfaqësuesi i palës së paditur në çmim të gjykatës. Gjykata, bazuar në nenin 305 të Kodit të Procedurës Civile, e deklaron të mbyllur hetimin gjyqësor, tërhiqet për vendim dhe në kthim vendosi pranimin e padisë. Procesverbali firmosur rregullisht. Nga aktet në dosje nuk rezulton që vendimi të jetë ankimuar nga palët ndërgjyqëse. Dosja gjyqësore, së bashku me vendimin e arsyetuar, janë depozituar nga gjyqtari në kryesekretari, në datën 18.11.2014, pas 1 dite nga shpallja, brenda afatit 10-ditor të përcaktuar në nenin 308 të Kodit të Procedurës Civile.

Gjykimi nga subjekti i rivlerësimit ka zgjatur gjithsej 1 muaj e 15 ditë. Kjo kohëzgjatje është brenda afatit 6-mujor të caktuar nga pika 5, shkronja “e” e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit. Rrjedhimisht, kohëzgjatja e gjykimit nga subjekti i rivlerësimit respekton standardin e procesit të rregullt ligjor, të përcaktuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së.

Dokumentacioni në dosjen e vëzhguar është i rregullt dhe aktet e krijuara apo të vlerësuara nga subjekti janë të sakta nga ana formale. Në dosje gjendet kërkesëpadija, vendimi për caktimin e seancës përgatitore, aktet e njoftimit të palëve, provat e paraqitura nga palët ndërgjyqëse, procesverbalet e seancave gjyqësore dhe vendimi gjyqësor. Veprimet e kryera në seancat gjyqësore të mësipërme janë dokumentuar në procesverbalet përkatëse, të cilat janë të rregullta nga pikëpamja formale dhe janë mbajtur sipas parashikimeve të neneve 118 dhe 158/a të Kodit të Procedurës Civile. Procesverbalet e seancave gjyqësore janë firmosur rregullisht. Procesverbalet e seancave përgatitore dhe gjyqësore janë mbajtur dhe dokumentuar me regjistrim audio. Dosja është sistemuar në mënyrë kronologjike. Aktet në dosje janë të inventarizuara rregullisht.

Vendimi është i ndarë në pjesën hyrëse, pjesën përshkuese-arsyetuese dhe pjesën dispozitivi i gjykatës. Në pjesën hyrëse të vendimit janë përshkruar trupi gjykues, palët duke specifikuar të dhëna

për përfaqësimin e tyre në gjykim, objekti e baza ligjore e padisë dhe kërkimet përfundimtare të palëve. Pjesa arsyetuese fillon me paraqitjen e plotë të objektit të padisë. Gjykata kryesisht, bazuar në nenet 32/c, 36/1, 42 e 43 të Kodit të Procedurës Civile, arrin në përfundimin se çështja bën pjesë në juridiksionin gjyqësor dhe është në kompetencën lëndore e tokësore të saj. Ka paraqitur deklaratimet e paditësit, të palës së paditur dhe provat e palës paditëse dhe të palës së paditur. Më tej, ka vijuar me çfarë ka rezultuar gjatë shqyrtimit gjyqësor lidhur me rrethanat e faktit, ka pasqyruar marrëdhënien juridike të krijuar mes palëve ndërgjyqëse dhe konfliktin e krijuar për shkak të caktimit të pjesshëm të pensionit të pleqërisë dhe mospranimit të ankimit, çka e ka detyruar paditësin të ngrëjë padi. Ka analizuar bazuar në nenin 32/c të Kodit të Procedurës Civile legjitimitetin e paditësit. Gjykata, pas dëgjimit të pretendimeve të palëve dhe analizimit të provave, ka çmuar se padia duhet të pranohet si e bazuar në ligj e prova dhe ka dhënë argumentet përkatëse. Bazuar në nenin 107/2 të Kodit të Procedurës Civile, ka çmuar se shpenzimet duhet të lihen siç janë bërë dhe ka çmuar se nuk është rasti për lëshimin e urdhrin të ekzekutimit. Pjesa e tretë, dispozitivi i gjykatës, nga pikëpamja formale është në përputhje me nenin 310, pika 3 e Kodit të Procedurës Civile. Aty është disponuar për pranimin e padisë, shpenzimet gjyqësore, të drejtën dhe afatin e ankimit.

Dosja 3. Çështja penale nr. *** regj., datë 13.10.2015, që i përket kërkesës së *** kundër të pandehurit L.M, akuzuar për veprën penale “Dhuna në familje”, parashikuar nga neni 130/a/1 e 3 të Kodit Penal.

Çështja është regjistruar në datën 13.10.2015 dhe me shortin e datës 13.10.2015 është caktuar gjyqtari Seladin Pysqyli. Me vendimin e datës 16.10.2015 (3 ditë nga shorti), gjyqtari ka vendosur kalimin e çështjes në seancën gjyqësore të datës 28.10.2015, ora 09:30, duke njoftuar palët ndërgjyqëse. Caktimi i seancës dhe data e saj respektojnë afatet e nenit 333 të Kodit të Procedurës Penale.

Janë zhvilluar 4 seanca gjyqësore; në seancën e katërt, prokurorja ka parashtruar në mënyrë sintetike rezultatet e hetimit. Mbrojtësja e të pandehurit paraqet konkluzionet. Gjykata, pasi dëgjoji diskutimin përfundimtar të palëve konform neneve 378/6 e 405 të Kodit të Procedurës Penale, e deklaroi të mbyllur shqyrtimin gjyqësor të çështjes. Gjykata tërhiqet për vendim dhe në kthim ka vendosur deklaratimin fajtor të të pandehurit dhe dënimin e tij për veprat penale, parashikuar nga neni 130/a/1 e 130/a/3 me 6 muaj burgim dhe, në aplikim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale, dënimin e tij përfundimisht me 4 muaj burgim. Në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal, pezullimin për një periudhë 18-mujore. Dispozitivi i vendimit paraqitet i plotë në procesverbal. Procesverbali është i nënshkruar rregullisht. Ndaj vendimit nuk rezulton të jetë paraqitur ankim.

Dosja gjyqësore, së bashku me vendimin e arsyetuar, janë depozituar në kryesekretari, në datën 1.12.2015 – pas 5 ditëve nga shpallja, brenda afatit 5-ditor të përcaktuar nga neni 113 i Kodit të Procedurës Penale.

Gjykimi nga subjekti i rivlerësimit Seladin Pysqyli ka zgjatur gjithsej 1 muaj e 10 ditë. Kjo kohëzgjatje është brenda afatit standard 9-mujor të caktuar nga pika 5, shkronja “a” e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit. Kohëzgjatja e gjykimin respekton standardin për një proces të rregullt ligjor, referuar nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së.

Dokumentacioni në dosjen e vëzhguar është i rregullt dhe aktet e krijuara apo të vlerësuara nga subjekti janë të sakta nga ana formale. Në dosje gjendet vendimi për kalimin e çështjes penale në gjykim, aktet e njoftimit të palëve, konkluzionet e prokurorit e mbrojtjes, vendimi i ndërmjetëm për ndarjen e çështjes, procesverbalet gjyqësore dhe vendimi gjyqësor. Të gjitha procesverbalet gjyqësore të administruara në dosje janë të plota, me të gjitha të dhënat dhe përshkrimet për veprimet procedurale të kryera, konform kërkesave të neneve 345/1 e 346 të Kodit të Procedurës Penale.

Gjithashtu, çdo procesverbal është i nënshkruar nga sekretarja gjyqësore dhe gjyqtari, konform nenit 345/2 të Kodit të Procedurës Penale. Dosja është e sistemuar në mënyrë kronologjike dhe në referencë të rregullave procedurale penale. Aktet në dosje janë të inventarizuara rregullisht, duke u bërë i lehtë shfrytëzimi i tyre nga palët.

Në procesverbalet e seancave në format letër evidentohet në mënyrë të drejtpërdrejtë mënyra e komunikimit të subjektit me palët ndërgjyqëse, pasi gjykimi i çështjes është kryer nga kryesuesi i seancës si gjyqtar i vetëm. Gjuha e përdorur në aktet e dosjes është normale komunikimi, në përputhje me etikën gjyqësore dhe e qartë, nuk ka përdorim të gjuhës diskriminuese apo elemente që lidhen me paanësinë e tij. Nuk ka të dhëna në dosje nëse ka pasur kërkesa për përjashtim të gjyqtarit.

Vendimi përmban elementet e përcaktuara nga neni 383 i Kodit të Procedurës Penale dhe është i ndarë në pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe në dispozitivin e gjykatës. Në pjesën hyrëse të vendimit është përshkruar gjykata, prokurori i çështjes, i pandehuri me gjeneralitete të plota dhe mbrojtësi i tij, akuza përkatëse, si dhe konkluzionet përfundimtare të palëve. Pjesa arsyetuese është e strukturuar. Ajo fillon me kërkesën e paraqitur nga prokurori për gjykimin e të pandehurit për kryerjen e veprës penale “Dhuna në familje”, parashikuar nga nenet 130/a/1 e 130/a/3 të Kodit Penal. I pandehuri, bazuar në nenin 403 të Kodit të Procedurës Penale, ka bërë kërkesë për gjykim të shkurtuar. Të pandehurat kërkuan procedimin me gjykim të zakonshëm. Bazuar në nenin 93 të Kodit të Procedurës Penale u kërkuar ndarja e çështjes për të pandehurin L. M. për t’u gjykuar më vete nga dy të pandehurat, për të përfituar nga gjykimi i shkurtuar. Prokurorja ra dakord me ndarjen e çështjes dhe gjykimin e shkurtuar. Gjykata, pasi u njoh me aktet e paraqitura nga prokuroria, bazuar në nenin 404 të Kodit të Procedurës Penale, vlerësoi pranimin e kërkesës, çështja mund të zgjidhej në gjendjen që ndodhen aktet, si dhe bazuar në nenin 93 ka vendosur ndarjen e çështjes dhe rihedhjen në short të çështjes për dy të pandehurat. Ka paraqitur në mënyrë të detajuar rezultatet e hetimit të prokurorisë. Gjykata ka parashtruar çfarë rezultoi gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe, në analizë, bazuar në prova, të elementeve të figurës së veprës penale, ka arritur në përfundimin se akuza në ngarkim të të pandehurit rezulton e provuar dhe ai duhet të deklarohet fajtor për konsumimin e veprës penale, parashikuar nga neni 130/a/1/3 i Kodit Penal. Më tej analizohet në lidhje me llojin dhe masën e dënimit. Gjykata ka mbajtur parasysh rrethanat lehtësuese në kuptim të neneve 48 e 49 të Kodit Penal, në caktimin e llojit dhe masës së dënimit dhe ka çmuar se i pandehuri paraqet rrezikshmëri shoqërore të ulët (i padënuar më parë), pranimi i akuzës dhe pendimi etj. Në përfundim, nisur edhe nga rrethanat e kryerjes së veprës penale, mosha, gjendja shëndetësore, veprimet e dhunshme të të pandehurave, ka çmuar se i pandehuri duhet të deklarohet fajtor dhe dënuar përfundimisht në aplikim edhe të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale me 4 muaj burgim, si dhe të pranohet kërkesën e prokurores për aplikimin e nenit 59 të Kodit Penal, duke u pezulluar ekzekutimi i vendimit për një periudhë prove prej 18 muajsh. Gjykata ka analizuar se në rastin konkret plotësohen kushtet dhe kriteret e parashikuara në nenin 59 të Kodit Penal. Është shprehur për detyrimin e të pandehurit në referim të nenit 61 të Kodit Penal për raportimin në shërbimin e provës, si dhe, meqenëse gjendet fajtor, duhet të paguajë shpenzimet procedurale në hetime paraprake, bazuar në nenin 393 të Kodit të Procedurës Penale në 1/3 dhe shpenzimet gjyqësore. Në pjesën e dispozitivit, gjykata ka vendosur deklarinimin fajtor të të pandehurit dhe dënimin e tij përfundimisht pas aplikimit edhe të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale me 4 muaj burgim. Në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal, pezullimin e ekzekutimit të vendimit, duke u vënë në provë për një periudhë prej 18 muajsh, si dhe aplikimin e nenit 61 të Kodit Penal. Në fund, gjykata është shprehur për shpenzimet gjyqësore, si dhe të drejtën e afatit të ankimit.

Dosja 4. Çështja penale nr. *** regj., datë 20.1.2016 regjistrimi, që i përket të pandehurit K.L, akuzuar për “Drejtim mjete në mënyrë të parregullt”, parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal”, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 4.2.2016.

Me vendimin e datës 22.1.2016 (2 ditë nga shorti) për caktimin e seancës gjyqësore, gjyqtari ka caktuar seancën gjyqësore për gjykimin e çështjes. Caktimi i datës së seancës respekton afatet e nenit 333 të Kodit të Procedurës Penale. Është zhvilluar një seancë gjyqësore. Bazuar në nenin 355 e 405 të Kodit të Procedurës Penale, gjykata deklaroi të hapur shqyrtimin gjyqësor dhe prokurori parashtrori rezultimet e hetimit dhe provat. Avokati i të pandehurit paraqet konkluzionet. I pandehuri K. L. e pranon akuzën dhe ndihet i penduar. Gjykata, bazuar në nenet 378/6 e 405 të Kodit të Procedurës Penale, e deklaroi të mbyllur shqyrtimin gjyqësor dhe tërhiqet për vendim dhe, në kthim, vendosi deklarinimin fajtor të të pandehurit për veprën penale, parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal dhe, pas aplikimit edhe të nenit 51 të Kodit Penal, e dënonte me 30 ditë burgim. Në aplikim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale, dënimin me 20 ditë burgim. Në aplikim të nenit 63 të Kodit Penal, zëvendësimin e tij me detyrimin të kryejë 40 orë pune në interes publik pa kundërshtim, duke paraqitur të plotë dispozitivin e vendimit. Ky vendim nuk rezultoi të jetë ankimuar.

Dosja gjyqësore dhe vendimi përfundimtar është dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit në sekretari, në datën 4.2.2016, ditën e shpalljes së vendimit, pra brenda afatit 5-ditor të parashikuar nga neni 113 i Kodit të Procedurës Penale.

Gjykimi i çështjes nga subjekti i rivlerësimit ka zgjatur 14 ditë. Kohëzgjatja e gjykimit është brenda afatit standard 9-mujor, të përcaktuar nga pika 5, shkronja “a” e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit. Rrjedhimisht, është respektuar standardi për një proces të rregullt ligjor të parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së.

Veprimet e kryera janë dokumentuar në procesverbal, i cili është firmosur në fund të fletës dhe në fund të procesverbalit nga sekretarja gjyqësore dhe gjyqtari i çështjes. Procesverbali gjyqësor përmbush kriteret e neneve 345 dhe 346 të Kodit të Procedurës Penale. Ai tregon orën e fillimit dhe të mbarimit të seancës gjyqësore. Në procesverbalin gjyqësor janë pasqyruar të plotë vendimet e ndërmjetme të gjykatës gjatë procesit, si dhe dispozitivi i vendimit përfundimtar. Aktet janë inventarizuar rregullisht dhe renditja e akteve të dosjes nuk vështirëson përdorimin e saj.

Vendimi gjyqësor përmban elementet e përcaktuara nga neni 383 i Kodit të Procedurës Penale dhe është i ndarë në pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe në dispozitivin e gjykatës. Në pjesën hyrëse të vendimit është përshkruar gjykata, prokurori i çështjes, i pandehuri me gjeneralitete të plota e mbrojtja, akuza përkatëse, si dhe konkluzionet përfundimtare të palëve. Pjesa arsyetuese e vendimit “Vëren” është e strukturuar. Ajo fillon me kërkesën e paraqitur nga prokurori për gjykimin e të pandehurit dhe akuza përkatëse. Bazuar në nenin 69/1, 74 e 76/1 të Kodit të Procedurës Penale, konstatohet juridiksioni gjyqësor dhe kompetenca lëndore e tokësore në shqyrtimin e çështjes. Pasqyrohet kërkesa e të pandehurit, bazuar në nenin 403 të Kodit të Procedurës Penale për gjykim të shkurtuar dhe pranimin e kërkesës nga gjykata, pasi vlerësoi se çështja mund të zgjidhej në gjendjen që janë aktet, bazuar në nenin 404 të Kodit të Procedurës Penale. Gjykata ka parashtruar çfarë rezultoi gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe në analizë ka arritur në përfundimin se akuza në ngarkim të të pandehurit rezultoi e provuar dhe se ai duhet të deklarohet fajtor për konsumimin e veprës penale, parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal. Gjykata ka mbajtur parasysh rrethanat lehtësuese në kuptim të neneve 48 e 49 të Kodit Penal në caktimin e llojit dhe masës së dënimit dhe ka çmuar se i pandehuri paraqet rrezikshmëri shoqërore të ulët (i padënuar më parë), pranimin e akuzës dhe pendimin, të qenit i mitur dhe fakti që vazhdon vitin e parë të shkollës së mesme. Në përfundim, gjykata ka çmuar se i pandehuri duhet të deklarohet fajtor dhe dënuar përfundimisht në aplikim edhe të nenit 406 të

Kodit të Procedurës Penale me 20 ditë burgim, si dhe të pranojë kërkesën e prokurorit për aplikimin e nenit 63 të Kodit Penal, duke u pezulluar ekzekutimi i vendimit me burgim dhe zëvendësimi me detyrimin e të pandehurit të përmbushë një punë në interes publik. Në pjesën e dispozitivit, gjykata ka vendosur deklarinim fajtor të të pandehurit për veprën penale të parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal dhe aplikimin e nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale, dënimin e tij me 20 ditë burgim. Në fund, gjykata është shprehur për shpenzimet gjyqësore që i ngarkohen të pandehurit, si dhe të drejtën e afatit të ankimit.

Dosja 5. Çështja penale (masë sigurimi) nr. ***, datë 5.11.2013, që i përket ***, me objekt “Vleftësim arresti në flagrancë dhe caktim mase sigurimi ndaj të dyshuarit H.Ç për veprën penale “Dhuna në familje” dhe “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të gjuetisë dhe sportive”, parashikuar nga nenet 130/a/1/2 e 280 të Kodit Penal”, e përfunduar me vendimin nr.***, datë 6.11.2013.

Seanca gjyqësore e datës 6.11.2013 është çelur në orën 09:06, është dokumentuar me procesverbal dhe me regjistrim audio në sallën penale 1. Në përmbajtje të procesverbalit evidentohet vendi, data, ora dhe përbërja e gjykatës, duke pasqyruar çështjen penale, palët ndërgjyqëse, si dhe objektin e bazën ligjore të kërkesës. Është verifikuar prezenca e palëve, shpallet trupi gjykues dakord me të. Kërkesa paraprake nuk ka. Gjykata, bazuar në nenin 49 të Kodit të Procedurës Penale, vendos të legjitimojë si mbrojtës kryesisht avokatin N. T., i cili është prezent dhe merr përsipër mbrojtjen. Mbrojtësi N. T. nuk ka kërkesa paraprake. Gjykata, bazuar në nenin 355 të Kodit të Procedurës Penale, deklaron të hapur shqyrtimin gjyqësor dhe fton prokurorin, i cili parashtron kërkesën dhe paraqet provat, të cilat citohen nga prokurori. I arrestuari jep shpjegime. Mbrojtësi i të arrestuarit deklaron se “Detyrimi për paraqitje” është masë më e përshtatshme. Gjykata, bazuar në nenin 151/2 dhe 357/1 të Kodit të Procedurës Penale, vendosi të lejojë dhe të marrë në shqyrtim provat e paraqitura nga organi i akuzës, citohen provat nga gjykata. Gjykata vendosi të ftojë palët në diskutimin përfundimtar; prokurori pranimin e kërkesës; avokati N. T. pranimin pjesërisht të kërkesës, caktimin e një mase më të butë; i arrestuari H. Ç. dakord me mbrojtësin; Gjykata, bazuar në nenin 378/6 të Kodit të Procedurës Penale, deklaron të mbyllur shqyrtimin gjyqësor. Gjykata tërhiqet për vendim dhe në kthim vendosi vleftësimin e ligjshëm të arrestimit në flagrancë dhe caktimin si masë sigurimi atë “Arresti në burg”. Nga aktet nuk rezulton që vendimi të jetë ankimuar.

Nga aktet e paraqitura nga gjykata rezulton se dosja gjyqësore, së bashku me vendimin e arsyetuar, është dorëzuar nga gjyqtari në datën 7.11.2013 – 1 ditë pas shpalljes së vendimit, brenda afatit 5-ditor të përcaktuar nga neni 113 i Kodit të Procedurës Penale.

Seanca gjyqësore dokumentohet të jetë zhvilluar në sallë gjykimi, si dhe është regjistruar audioja. Nga aktet e paraqitura evidentohen veprimet procedurale të kryera për organizimin e procesit gjyqësor, si vendimi i caktimit të seancës gjyqësore dhe aktet e njoftimit. Seanca është zhvilluar brenda afatit ligjor dhe me pjesëmarrjen e palëve në proces, duke u kujdesuar që edhe personi nën hetim të realizojë mbrojtjen me avokat të caktuar kryesisht.

Dokumentacioni në dosjen e vëzhguar është i rregullt. Në dosje ka vendim për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore dhe aktet e njoftimit të palëve për datën e seancës. Veprimet e kryera në seancën gjyqësore të mësipërme janë dokumentuar në procesverbalin përkatës, i cili është i rregullt nga pikëpamja formale dhe mbajtur sipas parashikimeve të nenit 345 të Kodit të Procedurës Penale, duke pasqyruar si orën e fillimit, edhe orën e përfundimit të seancës gjyqësore. Procesverbali i seancës gjyqësore është i firmosur rregullisht. Nga aktet rezulton se çështja është regjistruar në datën 5.11.2013 dhe vendimi është dhënë në datën 6.11.2013, pra brenda afatit të parashikuar nga dispozitat procedurale. Dosja është sistemuar në mënyrë kronologjike, duke u bërë lehtësisht e shfrytëzueshme për palët. Aktet në dosje janë të inventarizuara rregullisht.

Vendimi gjyqësor është akt i hartuar nga subjekti i rivlerësimit. Është vendim për vleftësim arresti dhe caktimin e masës së sigurimit, me të cilin është vendosur vleftësimi i arrestit në flagrancë dhe caktimi i masës së sigurimit “Arrest në burg”. Vendimi rezulton se është i strukturuar në pjesën hyrëse, përshkuese-arsyetuese dhe dispozitivin e gjykatës. Në pjesën hyrëse të vendimit janë përshkruar trupi gjykues, palët, objekti e baza ligjore dhe kërkimet përfundimtare të palëve. Pjesa arsyetuese është strukturuar. Fillon me kërkesën e paraqitur nga prokurori për vleftësimin e arrestit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit “Arrest në burg” për shtetasin H. Ç., si i dyshuar për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 130/a/1/2 e 280 të Kodit Penal. Ka analizuar juridiksionin dhe kompetencën e saj në gjykimin e çështjes. Ka paraqitur parashtrimet e prokurorit dhe pretendimet e tij se arrestimi është bërë në përputhje me nenin 252 të Kodit të Procedurës Penale dhe se, bazuar në nenin 228 e 229 të Kodit të Procedurës Penale, kërkoi caktimin e masës së sigurimit arrest në burg. Ka vijuar me pretendimin e mbrojtësit. Gjykata ka marrë në analizë vleftësimin e arrestit në flagrancë, nëse ekzistojnë apo jo kushtet për vleftësimin si të ligjshëm të arrestimit në flagrancë ndaj personit nën hetim H. Ç., në kuptim të neneve 251 e 252 të Kodit të Procedurës Penale. Në shqyrtim të kërkesës për kontrollin e ligjshmërisë së arrestimit në flagrancë, gjykata është bazuar në dispozitat procedurale penale, parashikuar nga nenet 251, 252, 254 e 258 të Kodit të Procedurës Penale, në rrethanat e faktit dhe ka arritur në konkluzionin se arrestimi në flagrancë duhet vlerësuar i ligjshëm, për arsye se personi i dyshuar është ndjekur dhe kapur menjëherë nga policia gjyqësore. Gjykata lidhur me kërkesën për caktimin e masës së sigurimit, mbi bazën e akteve të paraqitura që ndodhen në dosje, arrin në përfundimin se ekzistojnë kushtet e kriteret e parashikuara nga nenet 228 e 229 të Kodit të Procedurës Penale, të tilla si dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova se personi nën hetim H. Ç. mund të ketë konsumuar veprat për të cilat akuzohet dhe çmon se ndaj tij është i domosdoshëm caktimi i një mase sigurimi. Gjykata ka çmuar se është rasti i parashikuar nga neni 228/3, shkronja “c” e Kodit të Procedurës Penale, pasi ka rrezik të kryejë vepra të rënda ose të të njëjtit lloj, meqë i arrestuari abuzon me alkoolin dhe marrëdhëniet e tij me bashkëshorten kanë qenë jo të mira në vazhdimësi. Gjykata ka caktuar masën “Arrest në burg” të kërkuar nga prokurori dhe ka argumentuar vendimmarrjen. Pjesa dispozitivi i gjykatës është i qartë dhe është rrjedhojë e analizës së kryer nga gjykata në pjesën përshkuese-arsyetuese; pranuar kërkesa për vleftësimin e ligjshëm të arrestit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit “Arrest në burg”; Është urdhëruar izolimi i këtij shtetasi në IEVP Korçë, si dhe tregohet e drejta e ankimit dhe afati i ushtrimit të kësaj të drejte.

TË DHËNA NGA BURIME ARKIVORE TË KLGJ-së

96. Sipas të dhënave, rezulton se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit 8 tetor 2013 – 8 tetor 2016, për subjektin e rivlerësimit është paraqitur gjithsej 1 ankesë e vitit 2014 në Inspektoratin e ish-KLD-së. Kjo ankesë e vitit 2014 është verifikuar dhe për të është vendosur arkivimi, pasi nuk kanë rezultuar shkelje nga ana e gjyqtarit.

97. Sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore, për subjektin e rivlerësimit gjatë periudhës së rivlerësimit nuk është paraqitur asnjë kërkesë për procedim disiplinor nga Ministria e Drejtësisë apo të jetë marrë ndonjë masë disiplinore nga ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

ANALIZA E GJETJEVE

98. Analiza e gjetjeve u referohet të dhënave të nxjerra nga tri grupet e burimeve të informacionit: (i) formulari i vetëvlerësimit dhe dokumentacioni i paraqitur nga vetë subjekti; (ii) 5 dosjet e vëzhguara të përzgjedhura me short; (iii) të dhënat nga burimet arkivore në KLGJ.

98.1 Aftësitë profesionale

a) Njohuritë ligjore

Subjekti i rivlerësimit ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara është konstatuar se ai identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Zgjidh drejt çështjet në gjykim dhe, për pasojë, në disa raste palët bien dakord me zgjidhjen e çështjes dhe nuk e kundërshtojnë vendimin e dhënë në gjykatat më të larta. Në çështjet penale u kushton rëndësi të gjitha elementeve të veprës, si dhe ka njohuri edhe në të drejtën procedurale penale në gjykimin e kërkesave për vleftësim e caktim mase sigurimi personal. Zbaton me korrektesë procedurën e gjykimit të shkurtuar, kriteret për aplikimin e dispozitave të parashikuara nga nenet 59 e 63 të Kodit Penal. Në disa raste përdor referenca në vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë apo ligjet specifike. Ai ka njohuri për parimet e përgjithshme të së drejtës dhe i përdor ato në procedurën e gjykimit.

Nga ana tjetër, ndër 3 dokumentet e përzgjedhura dhe 5 dosjet e vëzhguara, janë ankimuar 3 prej tyre dhe Gjykata e Apelit ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë. Ndërsa në 5 rastet e tjera nuk është ushtruar ankim nga palët në proces.

b) Arsyetimi ligjor

Subjekti i rivlerësimit ka aftësi në arsyetimin ligjor. Vendimet gjyqësore të hartuara prej tij janë të qarta dhe të kuptueshme. Ai respekton rregullat e drejtshkrimit, në funksion të qartësisë së arsyetimit të vendimit gjyqësor, por nuk ka përdorur rregullisht të gjitha karakteret e gjuhës shqipe. Vendimet përfundimtare të tij plotësojnë kërkesat e legjislacionit procedural civil apo kërkesat e legjislacionit procedural penal.

Arsyetimi i vendimit është gjithëpërfshirës në raport me pretendimet e ngritura nga palët. Në tekstet e vendimit ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur gjyqtari. Në nxjerrjen e konkluzioneve i kushton rëndësi analizës së normës ligjore dhe, sipas rastit, e plotësuar me pjesë edhe nga jurisprudenca unifikuese e Gjykatës së Lartë. Një tipar i mirë i punës së tij është arsyetimi i vendimit me fokus në thelbin e çështjes dhe konkretizimi sipas rastit në mosmarrëveshje. Dispozitivi i vendimit është i plotë dhe i qartë, kur është rasti shoqërohet edhe me urdhrin e ekzekutimit, i cili nuk tregon zyrën e përmbartimit shtetëror ose privat si subjekti që ngarkohet për ekzekutimin e detyrueshëm të këtij vendimi dhe as faktin që urdhri i ekzekutimit lëshohet vetëm në një kopje.

Niveli i arsyetimit të vendimeve ligjore të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor. Në dispozitivin e vendimit, në të gjitha rastet e vëzhguara është konstatuar se disponohet për shpenzimet procedurale/gjyqësore, si dhe tregohet e drejta e ankimit për palët. Ai i kushton rëndësi arsyetimit të vendimeve të ndërmjetme, ku pasqyrohet shkaku dhe baza ligjore.

98.2 Aftësitë organizative

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Subjekti i rivlerësimit në periudhën e rivlerësimit 8.10.2013 – 8.10.2016 ka kryer detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë, duke punuar për një periudhë 2-vjeçare në dhomën civile e për një periudhë 1-vjeçare në dhomën penale. Ai ka deklaruar se nga tremujori i katërt i vitit 2013 deri në vitin 2016 i janë caktuar gjithsej 1461 çështje gjyqësore, ka përfunduar gjithsej 1270 çështje, si dhe ka mbartur 41 çështje të vitit 2016. Rendimenti i përfundimit të çështjeve bazuar në këto të dhëna është 86,9 %.

Sipas të dhënave statistikore të përcjella nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë për efekt të organizimit të shortit, konstatohet se për periudhën e rivlerësimit 8.10.2013 – 8.10.2016 gjyqtari Seladin Pysqyli ka përfunduar gjithsej 1104 çështje gjyqësore.

Sipas pikës 3, shkronja “e” e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit, në aspektin sasior gjyqtari i gjykatës së shkallës së parë, që është organizuar në dhomën civile, seksioni i përgjithshëm, duhet të jetë në cilësinë e relatorit në jo më pak se 120 gjykime çështjesh civile që kanë të bëjnë me mosmarrëveshje me palë kundërshtare. Gjithashtu, sipas pikës 3, shkronja “a” e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit, në aspektin sasior gjyqtari i gjykatës së shkallës së parë, që është organizuar në dhomën penale, duhet të jetë në cilësinë e relatorit në jo më pak se 100 gjykime çështjesh penale (krime e kundërvajtje), pra për 3 vjet jo më pak se 360 çështje civile me palë kundërshtare dhe jo më pak se 300 çështje penale (krime e kundërvajtje). Sipas të dhënave statistikore dhe atyre të paraqitura në formularin e vetëdeklarimit, të pasqyruara më lart, rezulton se gjyqtari Seladin Pysqyli në periudhën e rivlerësimit ka gjykuar për një periudhë 1-vjeçare 133 çështje penale (krime e kundërvajtje), si dhe për një periudhë 2-vjeçare 418 çështje civile me palë kundërshtare. Rrjedhimisht, ngarkesa e tij sasore ka qenë mbi standardin minimal.

b) Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore

Subjekti i rivlerësimit ka aftësi për planifikimin e organizimin e veprimeve të nevojshme dhe përgatitjen e çështjeve për gjykim në funksion të zgjidhjes së çështjeve. Në çdo dosje të vëzhguar, gjyqtari ka nxjerrë vendim formal për caktimin e seancës përgatitore apo gjyqësore, vendime të cilat janë marrë në një kohë të shkurtër nga dita e shortit - 3 ditë pas marrjes së çështjes me short dhe seancat gjyqësore janë caktuar në një afat kohor të arsyeshëm. Në çështjet civile, vendimi i kalimit të çështjes në seancë gjyqësore nuk është hartuar me akt të veçantë, por është pjesë e procesverbalit të veprimeve përgatitore. Në dosjet penale dhe të masës së sigurimit ka vendim për kalimin e çështjes penale në seancë gjyqësore, si dhe ka akte të njoftimit të palëve.

Ai kryen veprime përgatitore, të cilat kanë qenë efektive dhe i kanë shërbyer ecurisë së gjykimit. Orari i fillimit dhe i mbarimit të seancës gjyqësore është dokumentuar saktësisht në procesverbal. Nga vëzhgimi i tyre ka rezultuar se seancat gjyqësore janë zhvilluar në orarin e planifikuar. Nga vëzhgimi i 5 dosjeve të shortuara rezulton se të gjitha seancat gjyqësore janë zhvilluar në sallë gjykimi dhe janë regjistruar me sistemin audio.

Ai zhvillon dhe dokumenton procedurën e gjykimit gjatë drejtimit të procesit gjyqësor, duke ndjekur hapat që lidhen me çeljen e seancës, verifikimin e palëve me të drejtat dhe detyrimet procedurale, si dhe për prezantimin e gjykatës. Orienton drejt debatin dhe hetimin gjyqësor, marrjen e provave, kërkimet dhe prapësimet e palëve, diskutimin përfundimtar gjer në dhënien e vendimit përfundimtar. Për çdo kërkesë apo hap procedural merr rregullisht mendimin e palëve në gjykim. Ai u kushton rëndësi kërkimeve procedurale të palëve, në funksion të garantimit të pjesëmarrjes së plotë të palëve në proces dhe të dëgjimit të pretendimeve të tyre, si dhe kujdeset për të pasur palët të drejtën e mbrojtjes apo përfaqësimit me avokat. Disponon me vendime të ndërmjetme të arsyetuara për çdo veprim procedural të kryer gjatë gjykimit.

c) Aftësia për të administruar dosjet

Nga vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short nuk janë konstatuar mangësi. Në dosje gjenden të gjitha aktet e procesit gjyqësor të zhvilluar, si shorti, kërkesëpapia apo kërkesa penale për gjykim, procesverbali i seancave përgatitore apo gjyqësore, vendimet për caktimin e seancës përgatitore apo gjyqësore, vendimet përfundimtare, fletëthirrjet, provat etj. Aktet gjyqësore janë të rregullta nga pikëpamja formale.

98.3 Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

a) Etika në punë

Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave, nuk konstatohen të dhëna negative për etikën në punë të gjyqtarit Seladin Pysqyli. Gjithashtu, sipas të dhënave të regjistrimit të procedimeve disiplinore, për gjyqtarin përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk është paraqitur asnjë kërkesë për procedim disiplinor nga Ministria e Drejtësisë apo të jetë marrë ndonjë masë disiplinore nga ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

b) Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit Seladin Pysqyli dhe nga 5 dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij.

c) Paanësia

Nga të dhënat e sistemit TIMS ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit udhëton me av. A.Sh, anëtar i Dhomës së Avokatëve Korçë. Subjektit iu kërkua të provojë se nuk ka gjykuar çështje në të cilat përfaqësues është av. A.Sh, duke i kërkuar shpjegim në lidhje me këtë konstatim.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

“Në lidhje me udhëtimin datë 20.12.2008 në Maqedoni, ku rezulton se kam udhëtuar me mjetin e shtetasit Gj.L nga Korça dhe me të njëjtin mjet ka udhëtuar avokati A.Sh me djalin e tij dhe shtetasi T.G. Ky udhëtim ka qenë rastësor dhe me këtë avokat nuk kam pasur gjykime ku ai të ketë qenë përfaqësues i ndonjë pale në atë kohë, kurse më pas kam pasur gjykime.

Pavarësisht kësaj, di që automjeti ka qenë i shtetasit Gj.L, drejtohej prej tij dhe unë kam paguar shpenzimet e transportit”, është shprehur subjekti.

Në përgjigje të shpjegimeve, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar vetëm se ka pasur gjykime pas këtij udhëtimi, por nuk ka bërë prezent asnjë dokument ligjor për të provuar sa ka deklaruar lidhur me çështjet e gjykuara apo shpenzimet e mbuluara, pa e qartësuar se ku konsistonin këto shpenzime dhe arsyet e udhëtimit, të cilat mbeten të paqarta edhe pas marrjes së shpjegimeve nga subjekti i rivlerësimit.

Ai nuk paraqiti asnjë nga vendimet apo çështjet e trajtuara me këtë avokat, për të provuar që kur ky avokat mbronte interesat e palës paditëse, nuk ka pasur ndonjë trajtim që mund të krijojë dyshimin për krijimin e një situatë/trajtimi të favorshëm.

98.4 Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

a) Aftësitë e komunikimit

Në të gjitha dosjet gjyqësore të vëzhguara është konstatuar se subjekti i rivlerësimit komunikon me etikë me palët ndërgjyqëse. Ai ka aftësi komunikuese me palët, shfaq sjellje etike, duke ruajtur paanësinë në gjykim dhe respektuar barazinë e palëve.

b) Aftësia për të bashkëpunuar

Në të gjitha dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna mbi aftësinë e subjektit të rivlerësimit për të bashkëpunuar me kolegët, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta. Subjekti arsyetimin e vendimeve e ka realizuar brenda afateve ligjore, çka tregon se bashkëpunimi i tij me administratën gjyqësore në këtë drejtim ka qenë në nivelin e duhur.

c) *Gatishmëria për t'u angazhuar*

Subjekti i rivlerësimit, për shkak të funksionit të gjyqtarit të shkallës së parë, i nënshtrohet detyrimisht programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Në periudhën e rivlerësimit rezulton se subjekti ka marrë pjesë në 9 trajnime në Shkollën e Magjistraturës, gjithsej 11 ditë të formimit vazhdues. Lënda e trajnimeve ku ai ka marrë pjesë, ka një lidhje të arsyeshme me detyrën e gjyqtarit të shkallës së parë, në përbërje të dhomave civile e penale.

Lidhur me trajnime të tjera jashtë programit të Shkollës së Magjistraturës, subjekti ka deklaruar se nuk ka të tilla.

DENONCIME

99. Denoncim nr. * prot., datë 4.1.2018, i shtetasit O.L.** Denoncuesi denoncon shkelje të rënda të ligjit, se ka pasur zvarritje në procesin gjyqësor: *“Janë zhvilluar tri gjyqe nga i njëjti gjyqtar, ka dhënë vendime të padrejta në kundërshtim me ligjin, duke mos firmosur trashëgimtarët në kontratën e shitjes”*. Nisur edhe nga fakti se kjo çështje është bërë edhe mediatike, Komisioni vendosi të kërkojë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë dosjen gjyqësore që i përket vendimit nr. ***, datë 25.11.2013, me palë paditëse shtetasit O.L dhe A.L, me të paditur shtetasit N.L, H.L, E.L, D.L, F.L, M.M, Xh.M, S.V; person të tretë shtetasen Sh.Sh; me objekt padie “Njohje bashkëpronësie e palës paditëse dhe personit të tretë mbi pasurinë nr. ***”, me sipërfaqe të përgjithshme 1120 m² tokë arë dhe pasurinë nr. *** me sip 3730 m², duke u konstatuar pavlefshmëria absolute e kontratës së shitblerjes me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 18.12.2006, duke u rregulluar pasojat përkatëse që kanë sjellë këto veprime juridike absolutisht të pavlefshme. Pala e paditur D.L duhet t’u njohë dhe kthejë paditësve dhe personit të tretë tokën arë dhe truallin që u përket pasurive të përcaktuara më lart dhe të paditurve kundërvleftën monetare të sendeve të shitura.

Dosja përmban kërkesëpadinë, njoftimet e palëve, procesverbalet e seancës paraprahe, ka njoftime të përsëritura, për arsye se disa nga të paditurit nuk kanë marrë dijeni për datën dhe orën e gjykimit, duke sjellë edhe zvarritje te procesit. Data e regjistrimit të padisë është 19.6.2013, data e vendimit 25.11.2013; 5 muaj nga data e depozitimit të padisë gjykata ka disponuar me vendim, pra 5 muaj e 6 ditë brenda afatit të përcaktuar. Gjykata vëren se paditësit kërkojnë deklarin absolutisht të pavlefshëm të kontratës së shitblerjes me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 18.12.2006, të zyrës noteriale *** dhe kthimin e palëve në gjendjen e mëparshme, si dhe detyrimin e të paditurve të njohin bashkëpronarë paditësit dhe personin e tretë, bashkëpronarë për pasuritë nr. *** e ***.

Në analizë të provave të administruara konform neneve 12 dhe 213 të Kodit të Procedurës Civile ka rezultuar e provuar se paditësit janë vëllezër, kurse të paditurit E.L e D.L, si dhe personi i tretë Sh.Sh janë respektivisht vëllai dhe motrat e tyre. Të paditurit N.L dhe H.L janë prindërit e paditësve, kurse katër të paditurat e tjera i kanë halla (motrat e babait të tyre N.L). Pra, nga martesja e prindërve të paditësve kanë lindur 5 fëmijë dhe në datën 1.8.1991 ata kanë qenë në një familje bujqësore me prindërit. Në datën 1.8.1991 ka hyrë në fuqi ligji nr. 7501 “Për tokën” dhe familja bujqësore me kryefamiljar N.L ka përfituar tokë bujqësore në zbatim të këtij ligji. Kjo familje përbëhej nga 7 persona, që janë: dy paditësit O.L dhe A.L, të paditurit N.L, H.L, D.L, E.L dhe personi i tretë Sh.Sh. Të 7 anëtarët e familjes kanë përfituar një pjesë të barabartë, nga 7256 m² tokë dhe si familje 50.893 m² gjithsej. AMTP-ja është plotësuar në emër të kryefamiljarit N.L dhe, më pas, toka është regjistruar në ZVRPP-në Devoll.

Shtetasja Sh.L (gjyshja e paditësve, nëna e N.L) në datën 1.8.1991 ka qenë familje më vete, që përbëhej vetëm prej saj dhe ka përfituar tokë bujqësore në emrin e saj dhe s’ka lidhje me tokën e përftuar nga familja e djalit të saj, N.L. Në datën 2.2.2009, Sh.L ka ndërruar jetë dhe me vendimin

nr. ***, datë 15.1.2010, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, është lëshuar dëshmia e trashëgimisë dhe trashëgimtarë ligjorë janë 5 fëmijët e saj: N.L, F.Gj, M.M (L), Xh.M, dhe S.V. Prej disa vitesh paditësit jetojnë në familje më vete, personi i tretë Sh.Sh ka krijuar familje të re, kurse shtetasit E.L, D.L, N.L dhe H.L banojnë së bashku në një familje. Në datën 18.12.2006, me kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., të paditurit E.L, D.L, N.L dhe H.L, së bashku me shtetasen Sh.L i kanë shitur të paditurës D.L pasuritë me nr. *** dhe ***.

Pasuria me nr. *** përbëhet nga një sipërfaqe toke prej 1420 m², nga të cilat 300 m² truall mbi të cilën është ndërtuar një banesë me sipërfaqe ndërtimore 84 m². Pasuria me nr. *** përbëhet nga një sipërfaqe toke prej 4030 m², nga të cilat 300 m² truall, mbi të cilën është ndërtuar një banesë me sipërfaqe ndërtimore 96 m². Kontrata e shitjes është nënshkruar edhe nga shtetasja Sh.L në cilësinë e shitëses, por në fakt ajo nuk ka pasur çfarë të shesë, pasi nuk ka qenë bashkëpronare në ato dy pasuri. Të paditurat F.Gj, M.M, Xh.M dhe S.V nuk janë palë në atë kontratë, por pas vdekjes së nënës së tyre Sh.L ato kanë fituar pronësinë si bashkëtrashëgimtare për tokën bujqësore që Sh.L kishte fituar në bazë të ligjit nr. 7501/1991 “Për tokën”, tokë e cila nuk ka qenë objekt shitjeje. Pasi janë vënë në dijeni të kontratës së shitjes, paditësit i janë drejtuar me kërkesëpadi gjykatës, duke kërkuar detyrimin e të paditurve t’i njohin si bashkëpronarë, duke u anuluar kontrata e shitjes vetëm për tokën dhe jo për dy banesat e ndërtuara në të. Sa i takon kërtimeve në kërkesëpadi, gjykata vlerëson se paditësit dhe personi i tretë duhet të njihen bashkëpronarë për pasuritë nr. *** e ***, për nga 1/7 pjesë secili, duke konstatuar edhe pavlefshmërinë e veprimit juridik për këtë pjesë.

Gjykata arrin në përfundimin se:

Së pari, u provua se pasuritë objekt konflikti janë në bashkëpronësi të dy paditësve dhe të paditurit N.L, H.L, D.L dhe E.L dhe personit të tretë Sh.Sh, në kuptim të nenit 199⁵ të Kodit Civil.

Së dyti, në lidhje me veprimin juridik, nisur nga fakti që sendi ka qenë në bashkëpronësi të 7 personave dhe shitja është bërë vetëm nga tre prej tyre, gjykata çmon se kontrata e shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 18.12.2006, është një veprim juridik absolutisht i pavlefshëm për 3/7 pjesë të pasurisë së disponuar nëpërmjet saj, pasi bie ndesh me nenin 208 të Kodit Civil.

Së treti, nga veprimi juridik i shitjes ka ardhur si pasojë kalimi dhe regjistrimi i sendit në emër të paditëses D.L, kurse shitësit kanë marrë çmimin e shitjes. Pala paditëse ka kërkuar zgjidhjen e pasojave, duke u detyruar e paditura D.L t’u kthejë atyre pjesën e sendit në bashkëpronësi dhe të paditurve të tjerë çmimin e shitjes. Pala paditëse ka kërkuar zgjidhjen e pasojave, duke u detyruar e paditura D.L t’u kthejë atyre pjesën e sendit në bashkëpronësi dhe të paditurve të tjerë çmimin e shitjes.

Me vendimin nr. 5, datë 30.10.2012, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë njësuar praktikën gjyqësore, duke konkluduar se: *“Veprimi juridik që është i pavlefshëm, mund të merret parasysh nga gjykata edhe kryesisht, pa u kërkuar nga pala e interesuar, madje edhe kundër dëshirës së saj”*. Në gjykim rezultoi se kërkimi për pavlefshmërinë nuk është bërë si kërkim më vete, por së bashku me kërkimin në themel, që është njohja e bashkëpronësisë për sendin e shitur.

Gjykata çmon se kërkimi për kthimin e sendit është zgjidhur nëpërmjet pavlefshmërisë dhe njohjes së bashkëpronësisë, kurse, në lidhje me zgjidhjen e pasojave midis vetë të paditurve, paditësit nuk legjitimohen për këtë kërkim, pasi nuk kanë asnjë interes të ligjshëm, ndaj, meqenëse edhe nga të

⁵ Neni 199 i Kodit Civil: *“Ka bashkëpronësi kur një ose disa sende dhe të drejta të tjera reale u përkasin bashkërisht dy ose më shumë personave. Pjesët e bashkëpronarëve janë të barabarta, gjersa nuk vërtetohet e kundërta. Të drejtat dhe detyrimet e bashkëpronarëve caktohen në përpjesëtim me pjesët përkatëse”*.

paditurit nuk u kërkua një gjë e tillë, referuar vendimit unifikues gjykata nuk mund të shprehet për zgjidhjen e kësaj pasoje.

Paditësit nuk kanë kërkuar as fshirjen nga regjistri i ZVRPP-së të emrit së të paditurës D.L dhe regjistrimin e sendit në bashkëpronësinë e tyre, prandaj gjykata nuk mund të shprehet për detyrimin e ZVRPPP-së Devoll të kryejë këtë veprim, pasi ajo nuk është thirrur si palë në këtë gjykim. Referuar vendimit unifikues të Gjykatës së Lartë, palët në kontratë mund të kërkojnë zgjidhjen e këtyre pasojave nëpërmjet një padie tjetër apo t'i zgjidhin jashtëgjyqësisht me marrëveshje midis tyre. Gjykata, me vendimin nr. ***, datë 25.11.2013, ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë; konstatimin si pjesërisht absolutisht të pavlefshëm për 3/7-at pjesë të tokës (jo të banesave) të veprimit juridik, kontratën e shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 18.12.2006, për 3/7-at pjesë të tokës (jo banesave), të kryer midis shitësve N.L, H.L, E.L, e Sh.L dhe blerës D.L, për shitjen e pasurive nr. ***, nr. ***. Detyrimin e së paditurës D.L të njohë bashkëpronar paditësit O.L dhe A.L dhe personin e tretë Sh.Sh për pasuritë nr. ***, nr. ***, vetëm për sipërfaqen e tokës arë dhe truallit (jo për shtëpitë), duke i takuar së paditurës D.L 4/7 pjesë e tyre, paditësit O.L 1/7 pjesë, paditësit A.L 1/7 pjesë dhe personit të tretë Sh.Sh 1/7 pjesë.

Ky vendim u gjet i drejtë nga Gjykata e Apelit Korçë, e cila me vendimin nr. ***, datë 15.7.2014, vendosi lënien në fuqi të këtij vendimi si të bazuar në ligj dhe prova. Kundër këtij vendimi ka ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë avokati i të paditurve. Me vendimin nr. ***, datë 4.5.2022, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë vendosi mospranimin e rekursit të palëve të paditura kundër vendimit nr. ***, datë 15.4.2014, të Gjykatës së Apelit Korçë. Në dosje u konstatuan të gjitha aktet procedurale, si njoftimet e palëve, procesverbalet e seancave, procesverbali i kalimit të çështjes në seancë gjyqësore, kërkesat e palëve, provat, parashtrimet dhe qëndrimet e palëve në lidhje me zgjidhjen e mosmarrëveshjes, kopje të vendimit të gjykatës. Komisioni nuk konstatoi shkelje ligjore nga subjekti i rivlerësimit.

100. Denoncim nr. * prot., datë 25.3.2019, i shtetasit A.H.** Denoncuesi denoncon gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, gjyqtarët e Gjykatës së Apelit dhe prokurorin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë. Denoncuesi është dënuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë për kryerjen e veprës penale “Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike” me një vit e 6 muaj burgim dhe 400.000 lekë gjobë. Prokurorët dhe gjyqtarët e përfshirë në çështjen ndaj tij kanë treguar paaftësi totale në detyrën e tyre, nuk njohin normat bazë për të cilat ligji i ka ngarkuar për përdorim dhe zgjidhjen e drejtë të çështjes. Denoncimit i ka bashkëlidhur kopje të vendimit gjyqësor me nr. *** me shënimin: *“Ndaj këtij vendimi është bërë ankimi dhe Gjykata e Apelit Korçë me vendimin nr. ***, datë 12.1.2012, vendosi: Lënien në fuqi të këtij vendimi. Nga rrethanat dhe faktet e bëra prezent ky denoncim nuk përmbush kriteret e nenit 53 të ligjit nr. 84/2016”.*

101. Denoncim i shtetasit S.P, nr. * prot., datë 31.5.2021; nr. *** prot., datë 21.6.2021; nr. *** prot., datë 4.6.2021.** Denoncuesi kërkon marrjen e masës administrative ndaj gjyqtarit Seladin Pysqyli, gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, i cili po shqyrton çështjen me palë dhe objekt R.P; i paditur N.R, S.P, me objekt “Marrjen e masës së sigurimit të padisë”, duke pezulluar ekzekutimin e titullit ekzekutiv, vendimi nr. ***, datë 19.2.2007, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, lënë në fuqi nga vendimi nr. ***, datë 12.12.2017, së bashku me urdhrin e ekzekutimit vendimi nr. ***, i datës 18.1.2018, derisa vendimi të marrë formë të prerë. Përfshirimin e sendit nga ekzekutimi të banesës private, z. k. ***, komuna ***, me sipërfaqe 540 m², sipërfaqe ndërtimi 126.34 m², njëkatëshe, pasi në asnjë moment nuk është gjykuar pjesa e saj që rrjedh nga bashkësia ligjore; Anulimin e veprimeve përmbartimore për ekzekutimin e titullit ekzekutiv vendimi nr. ***, datë

19.2.2007, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, lënë në fuqi nga vendimi nr. ***, datë 12.12.2007, së bashku me urdhrin e ekzekutimit të vendimit nr. ***, datë 18.1.2018, për shkak se nuk ka garantuar një proces të rregullt ligjor.

Denoncuesi denoncon shkelje të etikës nga ana e subjektit të rivlerësimit, cenim të procesit të rregullt ligjor nga ana e tij, pasi nuk i ka dhënë fjalën palës së paditur, shpreh keqardhje për z. N.R, pasi është në moshë të madhe dhe vjen ende nëpër procese gjyqësore. Gjyqtari sipas denoncuesit duhet të jetë i paanshëm në një proces gjyqësor jo vetëm në dhënien e vendimit, por edhe në dukje gjatë zhvillimit të procesit gjyqësor. Denoncuesi nuk ka bashkëlidhur dokumentacion ligjor.

Nga rrethanat e çështjes kuptohej se çështja në vitin 2021 ka qenë duke u gjykuar nga subjekti i rivlerësimit dhe Komisioni ka kërkuar informacion në lidhje me vendimmarrjen e subjektit të rivlerësimit. Në këto kushte, është kërkuar dosja pranë Gjykatës në lidhje me çështjen civile me palë dhe objekt si më sipër. Me shkresën nr. *** prot., datë 8.5.2024, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë ka dërguar aktet dhe informacionin e kërkuar.

Kjo çështje civile është shortuar në datën 4.6.2018. Çështja objekt gjykimi i është ngarkuar gjyqtarit G.D. Në seancën përgatitore, ky gjyqtar ka vendosur pranimin e kërkesës për pezullimin e procedurës përmbartimore, duke urdhëruar shoqërinë përmbartimore *** sh.p.k. të pezullojë deri në përfundimin e këtij gjykimi procedurën përmbartimore për ekzekutimin e titullit ekzekutiv, vendimi nr. ***, datë 19.2.2007, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, lënë në fuqi me vendimin nr. ***, datë 12.12.2017, të Gjykatës së Apelit Korçë, kundrejt garancisë prej 150.000 lekësh, vendosur në dispozicion të palës së paditur. Pas delegimit të këtij gjyqtari nga KLGJ-ja në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë, kjo çështje iu nënshtrua shortit elektronik, duke u ngarkuar me gjykimin e saj gjyqtarja A.K. Gjatë gjykimit të çështjes nga kjo gjyqtare janë paraqitur dy kërkesa për përjashtimin e saj nga ky gjykim.

Me vendimin nr. *** prot., datë 13.12.2018, gjyqtari i ngarkuar me shqyrtimin e kërkesës për përjashtimin e gjyqtares A.K ka disponuar me rrëzimin e kërkesës së kërkueses R.P. Në datën 26.12.2018, paditësja R.P ka depozituar në gjykatë një kërkesë tjetër me objekt përjashtimin e kësaj gjyqtareje. Për gjykimin e kësaj kërkesë është caktuar gjyqtari Seladin Pysqyli, i cili me vendimin nr. *** prot., datë 4.1.2019, ka disponuar në këtë mënyrë: të rrëzojë si të pabazuar kërkesën e kërkueses R.P me objekt përjashtimin e gjyqtares A.K nga gjykimi i kësaj çështjeje dhe, bazuar në nenin 76/2, gjobitjen e paditëses R.P me gjobë 5.000 lekë.

Me vendimin e datës 22.1.2019, nënkryetarja e Gjykatës ka vendosur pranimin e dorëheqjes së gjyqtares A.K nga gjykimi i çështjes civile, që i përket paditëses R.P. Kjo dorëheqje është pasojë e kallëzimit penal të depozituar nga paditësja R.P, S.P për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës” nga ana e gjyqtares, neni 248 i Kodit Penal.

Më pas, kjo çështje u rishortua dhe nga shorti elektronik iu ngarkua gjyqtares E.M, për të cilën paditësja R.P në datën 19.4.2019 ka depozituar kërkesë për përjashtimin e saj nga gjykimi me pretendimet e parashtruara si më sipër. Me shqyrtimin e kësaj kërkesë ishte ngarkuar gjyqtarja F.D. Më pas, çështja është rishortuar dhe shorti i ka rënë qytetarit Seladin Pysqyli. Pasi u zhvilluan disa seanca, të cilat janë shtyrë me pretekstin se paditësja nuk ka avokat, avokati kërkon kohë të njihet me provat, me rregullimin e ndërëgjyqësisë etj. dhe në seancën e datës 15.4.2021 është kërkuar përjashtimi i gjyqtarit Seladin Pysqyli, me arsyen se gjyqtari ka treguar kujdes ndaj një pale kundrejt palës tjetër, duke bërë që gjykata të dukej e njëanshme. Me vendimin e datës 21.4.2021 është vendosur mospranimi i kërkesës për përjashtimin e gjyqtarit Seladin Pysqyli nga zëvendëskryetarja e gjykatës.

Në datat 9.5.2021 dhe 12.5.2021 është paraqitur përsëri kërkesë për përjashtimin e gjyqtarit Seladin Pysqyli. Kërkesa për përjashtimin e gjyqtarit Seladin Pysqyli është gjykuar nga gjyqtari M.Q dhe është nënshkruar nga avokatja e paditëses R.P. Gjyqtari M.Q me vendimin datë 14.5.2021 për shqyrtimin e kërkesës për përjashtimin e gjyqtarit Seladin Pysqyli arsyeton se: *“Gjykata tërhoqi fashikullin e gjykimit të çështjes civile datë 4.6.2018, që është duke u gjykuar nga gjyqtari Seladin Pysqyli, për të cilin kërkohet përjashtimi. Deri në këtë fazë janë kërkuar përjashtimet për 3 gjyqtarë dhe janë angazhuar 6 gjyqtarë. Të gjithë gjyqtarët janë përjashtuar me kërkesën e palës paditëse. Janë zhvilluar gjithsej 28 seanca gjyqësore dhe një nga shkaqet e zvarritjes se këtij gjykimi janë kërkesat e palës paditëse, të cilat kanë për qëllim të godasin gjyqtarët në aspektin procedural (në të shumtën e rasteve kërkesat janë rrëzuar dhe paditësja është gjobitur). Në asnjë moment nga procesverbalet e seancave që janë zhvilluar nga ky gjyqtar, nuk është hasur shprehja si “kot mundohesh”, nuk u konstatuan shprehje si “qarje halli” palës së paditur, “po lodhesh që vjen nëpër seanca gjyqësore”. Sa më sipër, pretendimet e paditëses dhe mbrojtëses së saj në lidhje me njëanshmërinë e gjyqtarit mbeten në kuadrin deklarativ dhe hamendësime të tyre të pambështetura në ligj. Në këto kushte, gjykata ka vendosur deklarinimin e papranueshëm të kërkesës së R.P për përjashtimin e gjyqtarit Seladin Pysqyli dhe, mbështetur në nenin 76/2 të Kodit të Procedurës Civile, paditësja R.P gjobitet me 7.000 lekë gjobë”*. Kërkesa për përjashtim të gjyqtarit është përsëritur sërish nga paditësja R.P dhe në datën 26.5.2021 gjyqtari B.Sh ka vendosur mospranimin e kërkesës për përjashtimin e gjyqtarit Seladin Pysqyli. Në seancën e datës 10.6.2021, i padituri S.P ka paraqitur kërkesë për dorëheqje të gjyqtarit Seladin Pysqyli, pasi ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit.

Në datën 10.6.2021, gjyqtari Seladin Pysqyli paraqet një kërkesë për heqje dorë nga gjykimi i çështjes me palë dhe objekt si më sipër, për arsye se i padituri kishte depozituar përsëri kërkesë për përjashtimin e trupit gjykues. Po kështu, pak para çeljes së seancës nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë, gjyqtarit i është njoftuar një kërkesëpadi me paditës shtetasin S.P, të paditur gjyqtarin Seladin Pysqyli dhe Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë, me objekt “Shpërblim dëmi jopasuror”.

Me vendimin e datës 11.6.2021, zëvendëskryetarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë vendosi pranimin e kërkesës së gjyqtarit Seladin Pysqyli nga ngarkimi i çështjes civile, regjistruar në datën 4.6.2018, që i përket paditëses R.P, të paditur N.R, S.P, person i tretë shoqëria përmbarimore *** sh.p.k., me objekt përjashtimin e sendit nga ekzekutimi etj.

Kjo çështje iu nënshtrua shortit dhe i ra për gjykim gjyqtarit E.S. Konstatohet nga fashikujt gjyqësorë se edhe për këtë gjyqtar rezulton se paditësja R.P ka kërkuar përjashtimin.

Nga fashikulli i vënë në dispozicion të Komisionit është konstatuar se në lidhje me këtë çështje ka pasur shumë kërkesa procedurale për përjashtim gjyqtarësh, kërkesa nga avokatët për shtyrje të seancave gjyqësore. Është abuzuar shumë me këto kërkesa dhe, në përfundim, gjykata në disa raste ka aplikuar edhe gjobë për zvarritje të procesit nga pala paditëse.

Vendimi përfundimtar për këtë çështje është marrë në datën 7.12.2023 nga gjyqtari E.S, i cili ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë; heqjen e masës së sigurimit të padisë të vendosur me vendimin nr. *** të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, e cila zbatohet kur vendimi të marrë formë të prerë dhe kthimin e garancisë në vlerën 150.000 lekë paditëses R.P brenda 15 ditëve nga marrja e vendimit formë të prerë, nëse pala tjetër nuk paraqet vendim për shpërblimin e dëmit të ardhura për një shkak të tillë.

Denoncuesi ka depozituar edhe një vendim të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë “Për sigurimin e padisë”, datë 14.6.2021, e cila ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë me objekt si më sipër si të pabazuar në prova dhe në ligj.

Ky vendim i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë është dhënë nga gjyqtarja E.Gj. Shkaku i rrëzimit të padisë së denoncuesit sipas gjykatës është se paditësi (denoncuesi), duke pasur barrën e provës, nuk provon kushtet ligjore për sigurimin e padisë dhe, për më tepër kur edhe objekti i padisë nuk ka asnjë lidhje me llojin e masës së kërkuar, siç orienton e unifikon Gjykata e Lartë, vlerësohet se kërkesa duhet të rrëzohet si e pabazuar në prova dhe në ligj. Sa më sipër, subjektit i është kërkuar të japë shpjegime në lidhje me këtë denoncim.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Në lidhje me denoncimin e shtetasit S.P, i cili ka pretenduar për shkelje të etikës nga ana ime dhe cenim të procesit të rregullt ligjor, pasi nuk i kam dhënë fjalën në seancë dhe se kam shprehur keqardhje për të paditurin N.R, shpjegoj si vijon:

*Nga unë gjyqtari Seladin Pysqyli ka qenë për gjykim çështja civile me nr. regj. ***, datë regjistrimi 4.6.2018, me paditëse R.P (bashkëshortja e denoncuesit), të paditur N.R dhe S.P, person i tretë shoqëria përmbarimore “***” sh.p.k. me objekt: 1- Marrjen e masës së sigurimit të padisë, duke u pezulluar ekzekutimi i titullit ekzekutiv, vendimi nr. ***, datë 19.2.2007, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë; 2- Përjashtimin e sendit nga ekzekutimi, banesë me sipërfaqe 126,3 m² dhe sipërfaqe trualli 540 m², e ndodhur në fshatin ***, z. k. ***, 3- Anulimin e veprimeve përmbarimore në lidhje me ekzekutimin e titullit ekzekutiv vendimin nr. ***, datë 19.2.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.*

*Fillimisht, çështja i është caktuar për gjykim gjyqtares F.D, e cila ka paraqitur kërkesën për heqje dorë dhe kërkesa është pranuar me vendimin datë 5.6.2018 të kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë. Çështja është rihedhur në short dhe i është caktuar për gjykim gjyqtarit G.D, i cili ka shqyrtuar kërkesën e paditëses me objekt “Marrja e masës së sigurimit të padisë”, duke pezulluar veprimet përmbarimore të shoqërisë përmbarimore “***” sh.p.k. në lidhje me ekzekutimin e titullit ekzekutiv, vendimin nr. ***, datë 19.2.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë. Më pas, gjyqtari G.D është komanduar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë, prandaj çështja është rihedhur në short në datën 20.6.2018 dhe i është caktuar për gjykim gjyqtares A.K.*

Ndaj gjyqtares A.K janë paraqitur disa kërkesa për përjashtim, të cilat nuk janë pranuar.

Në datën 22.1.2019, gjyqtarja A.K ka paraqitur kërkesë për heqje dorë nga gjykimi, pasi R.P kishte kërkuar përsëri përjashtimin e saj dhe njëkohësisht kishte bërë kallëzim penal për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, duke i vënë në dispozicion dhe një kopje të kallëzimit. Kërkesa për heqje dorë është pranuar me vendimin datë 22.1.2019 të zv. kryetares së Gjykatës, znj. L.K.

Pas pranimit të dorëheqjes së gjyqtares A.K, çështja është rihedhur në short dhe i është caktuar gjyqtares E.M. Edhe ndaj kësaj gjyqtareje janë paraqitur disa kërkesa për përjashtim, të cilat nuk janë pranuar. Në seancën e datës 8.5.2019, i padituri S.P ka kërkuar përjashtimin e gjyqtares dhe në datën 20.5.2019, gjyqtarja E.M ka bërë kërkesë për heqje dorë nga gjykimi, pasi përveç kërkesës për përjashtim, i padituri S.P kishte bërë kallëzim penal ndaj saj. Kërkesa për heqje dorë është pranuar me vendimin datë 20.5.2019 të zv. kryetares së Gjykatës, znj. L.K.

Pas pranimit të dorëheqjes së gjyqtares E.M, çështja i është caktuar për gjykim gjyqtarit M.K. Ndaj këtij gjyqtari janë paraqitur disa kërkesa për përjashtim, të cilat nuk janë pranuar. Paditësja R.P ka kërkuar thirrjen me cilësinë e të paditurve Komisionin e Pavarur të Kualifikimit dhe Organizatën e Monitorimit Ndërkombëtar. Kjo kërkesë është vlerësuar si kanosje nga gjyqtari M.K, i cili në datën 30.10.2019 ka bërë kallëzim penal ndaj paditëses R.P. Bazuar në këtë kallëzim, në datën 31.10.2019 ka paraqitur kërkesë për heqje dorë nga gjykimi, e cila është pranuar me vendimin datë 02.11.2019

të zv. kryetares, znj. L.K. Pas pranimit të dorëheqjes, çështja është rihedhur në short dhe më është caktuar për gjykim mua, gjyqtarit Seladin Pysqyli.

Nga ana ime janë zhvilluar disa seanca përgatitore, ku paditësja ka kërkuar thirrjen me cilësinë e të paditurve Komisionin e Pavarur të Kualifikimit dhe Organizatën e Monitorimit Ndërkombëtar.

Kjo kërkesë nuk është pranuar dhe, nisur nga ky fakt, ajo ka kërkuar thirrjen e këtyre institucioneve me cilësinë e personave të tretë. Edhe kjo kërkesë nuk është pranuar dhe paditësja ka shfrytëzuar të drejtën e ankimit në Apel. Vendimi është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Korçë dhe, pas kthimit të dosjes, gjykata i ka lënë detyrë paditëses për të rregulluar ndërgjyqësinë në anën e të paditurve, konform nenit 161/ç të Kodit të Procedurës Civile. Pas këtij momenti, paditësja dhe i padituri S.P (bashkëshorti i saj) para çdo seance kanë paraqitur kërkesa për përjashtimin e trupit gjykues. Meqenëse kërkesat e përjashtimit nuk janë pranuar, i padituri S.P ka ngritur padi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Korçë, duke paditur gjyqtarin Seladin Pysqyli dhe Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë, si dhe ka kërkuar shpërbllim dëmi. Nisur nga ky fakt, kam paraqitur kërkesë për heqjen dorë, e cila është pranuar dhe, pas rihedhjes në short, çështja i është caktuar gjyqtarit E.S.

Pas pranimit të kërkesës sime për heqje dorë dhe ndryshimin e trupit gjykues, i padituri S.P nuk ka treguar interes për gjykimin dhe as ka plotësuar të metat e padisë të ngritur në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Korçë, e cila me vendimin nr. ***, datë 1.10.2021, ka vendosur kthimin e padisë së bashku me aktet si të paplota. Që nga ngritja e padisë, pas marrjes së masës së sigurimit të padisë, është vijuar me kërkesa përjashtimi për çdo seancë gjyqësore, madje duke paraqitur dhe dy kërkesa përjashtimi, një ditën e seancës dhe një tjetër gjatë kohës midis dy seancave. Të gjitha kërkesat janë deklaruar të papranueshme dhe ndaj kërkueses është aplikuar dënimi me gjobë.

Në kushtet kur nga gjykata nuk është zhvilluar asnjë seancë efektive, por vetëm sa janë çelur dhe shtyrë në pritje të shqyrtimit të kërkesave të përjashtimit, denoncuesi S.P nuk mund të pretendojë se nuk i është dhënë fjala dhe se unë jam treguar i njëanshëm, pasi në gjithë seancat është relatuar vetëm në lidhje me kërkesat për përjashtim gjyqtari.

102. Denoncim nr. * prot., datë 21.3.2019, i shtetasit M.G.** Denoncuesi denoncon disa subjekte rivlerësimi të emëruar si gjyqtarë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë dhe gjyqtarë të Gjykatës së Apelit Korçë për dhënie vendimesh të padrejta. Denoncimit nuk i ka bashkëlidhur asnjë dokument ligjor. Në këto kushte, ky denoncim nuk i përmbush kriteret e nenit 53 të ligjit nr. 84/2016.

103. Denoncim nr. * prot., datë 8.4.2019, i shtetasit Gj.S.** Denoncuesi ankohet ndaj subjektit të rivlerësimit, pasi ka kërkuar përjashtimin e gjyqtarit në shqyrtimin e çështjes, kërkesë e cila nuk është pranuar nga një tjetër trup gjykues i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë. Denoncuesi ka vazhduar përsëri me të njëjtën kërkesë dhe gjyqtari ka ndërprerë seancën për të vendosur në lidhje me këtë kërkesë të re një trup tjetër gjykues. Nuk vërehet shkelje e dispozitave të Kodit të Procedurës Civile nga ana e subjektit të rivlerësimit. Gjithashtu nuk vërehen shkelje të rregullave të etikës nga ana e tij.

104. Denoncim nr. * prot., viti 2019, i shtetasve T.H, I.R, P.Sh.** Denoncuesit janë një grup të dënuarish që vuajnë dënimin në I EVP-në Korçë, të cilët denoncojnë për korrupsion gjyqtarë dhe prokurorë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë. Ata nuk tregojnë veprime konkrete në shkelje të ligjit nga ana e subjekteve të rivlerësimit. Nuk i kanë bashkëlidhur denoncimit ndonjë vendim të

subjektit të rivlerësimit. Denoncimi nuk i përmbush kriteret e përcaktuara nga neni 53 i ligjit nr. 84/2016.

105. Denoncim nr. * prot., datë 1.12.2017, i shtetasve S.M dhe N.M.** Në këtë denoncim, denoncuesit nuk tregojnë se cilat janë veprimet që janë në kundërshtim me ligjin, që janë kryer nga subjekti i rivlerësimit. Denoncimi më shumë akuzon veprimet hetimore të prokurorit të çështjes. Në këto rrethana, ky denoncim nuk plotëson kriteret e përcaktuara nga neni 53 i ligjit nr. 84/2016.

106. Denoncim nr. * prot., datë 18.4.2019 dhe nr. *** prot., datë 30.4.2019, i shtetasit F.M.** Denoncuesi pretendon se *“subjekti ka dhënë një vendim të padrejtë, nuk është bazuar në dokumentet e pronës, dyshoj se ka rënë në kompromis për qëllime përfitimi me palën e paditur”*. Denoncimit i ka bashkëlidhur kopje të kërkesëpadisë, dokumente hipotekore, fletëthirrje, kopje të fragmentit të hartës ku ndodhet prona objekt gjykimi, si dhe vendimin nr. ***, datë 17.4.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë. Nga vendimi i vënë në dispozicion konstatohet se denoncuesi është palë paditëse në një proces gjyqësor me objekt lirim dhe dorëzim sendi (padi rivendikimi) për një sipërfaqe trualli të zënë nga i padituri shtetasi F.L. Gjykata ka shqyrtuar çështjen bazuar në dokumentacion hipotekor të paraqitur nga palët, ka zhvilluar një hetim gjyqësor të çështjes, duke vendosur një ekspert të vlerësimit të pasurive të paluajtshme dhe, bazuar në konkluzionet e ekspertit që për pronat e paditësit dhe të paditurit nuk ka mbivendosje, ka vendosur të rrëzojë padinë e paditësit Gj.M si të pambështetur në ligj dhe prova. Nga vendimi, Komisioni konstatoi se subjekti i rivlerësimit në aspektin e njohurive ligjore demonstroi aftësi në drejtim të njohjes së normës materiale dhe arsytimit ligjor. Subjekti i rivlerësimit merr në analizë dispozita të Kodit Civil dhe Kodit të Procedurës Civile dhe i interpreton ato.

107. Denoncim nr. * prot., datë 6.9.2019, i shtetasit A.S.** Ky denoncues denoncon se subjekti i rivlerësimit nuk i ka marrë për bazë dokumentet dhe dëshmitarët e paraqitur nga ai në seancën gjyqësore të datës 16.11.2015 dhe denoncuesi tani nuk e gjen të drejtën e tij dhe nuk merr pension, duke i pasur vitet e punës dhe dokumentet në rregull sipas tij. Denoncimit nuk i ka bashkëlidhur asnjë vendim të subjektit të rivlerësimit. Në këto kushte, ky denoncim nuk përmbush kriteret e nenit 53 të ligjit nr. 84/2016.

108. Denoncim nr. * prot., datë 11.12.2017, i shtetasit J.M.** Denoncuesi denoncon gjyqtarët e Gjykatës së Apelit E.P dhe gjyqtarin e Gjykatës së Shkallës së Parë, Seladin Pysqyli në lidhje me bllokimin e dyerve dhe dritareve të shtëpisë së tij dhe makinën tip “Fuoristradë”. Denoncimit i ka bashkëlidhur një vendim gjykate të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë “Për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit”, ku debitor është denoncuesi. Ky vendim nuk është lëshuar nga subjekti i rivlerësimit. Gjithashtu, bashkëlidhur denoncimit ka dërguar edhe një vendim të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si dhe një vendim për mosfillimin e procedimit penal të datës 14.6.2014. Denoncimi nuk ka bashkëlidhur asnjë vendim të nxjerrë nga subjekti i rivlerësimit që të tregojë shkelje të ligjit nga ana e tij. Në këto kushte, ky denoncim nuk i përmbush kriteret e përcaktuara nga neni 53 i ligjit nr. 84/2016.

109. Denoncim nr. * prot., datë 12.11.2019, i shtetasës Xh.Q.** Denoncuesja është ankuar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë se prokurori i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Korçë ka vendosur mosfillimin e çështjes lidhur me një kallëzim që ajo ka bërë në emër të nënës së saj, të cilën ajo e përfaqëson me prokurë. Kundër vendimit të mosfillimit të procedimit penal, ankuesja së bashku me avokatin ka bërë ankim në gjykatë. Rezulton që ankimi në gjykatë ndaj vendimit për mosfillimin e procedimit penal është bërë në emrin e ankueses dhe jo në emrin e nënës, të cilën ajo e përfaqëson me prokurë. Çështja është gjykuar nga subjekti i rivlerësimit, i cili në bazë të nenit 291, pika 2 e

Kodit të Procedurës Penale⁶, vendosi mospranimin e ankimit për moslegjitimim të ankueses. Nga vendimi, Komisioni konstatoi se subjekti i rivlerësimit në aspektin e njohurive ligjore demonstroi aftësi në drejtim të njohjes së normës procedurale dhe arsyetim ligjor. Subjekti i rivlerësimit merr në analizë dispozita të Kodit të Procedurës Penale dhe i interpreton ato.

110. Denoncim nr. * prot., datë 3.2.2023, i shtetasit S.B.** Denoncuesi ankohet në lidhje me mosthirrjen e tij në gjykim nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, me palë Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë dhe të pandehur shtetasin A.R, akuzuar për veprën penale “Ndërtimi i paligjshëm”, parashikuar nga neni 199/a/3 i Kodit Penal. Denoncuesi kallëzon se pas kryerjes së hetimeve nga ana e organit procedues penal është dërguar çështja në Gjykatë dhe Prokuroria ka njoftuar për përfundimin e hetimeve edhe shtetasin S.B, bashkortak në biznes me të pandehurin. Gjatë veprimeve hetimore denoncuesi është pyetur në lidhje me ndërtimin e paligjshëm që është kryer nga i pandehuri dhe ka dhënë dëshminë e tij në lidhje me këtë çështje. Denoncuesit në cilësinë e viktimës i është komunikuar nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë njoftimi për përfundimin e hetimeve të procedimit penal nr. *** dhe pretendon se subjekti i rivlerësimit nuk i ka dërguar ftesë në lidhje me gjykimin e procedimit penal nr. ***. Denoncuesi pretendon se subjekti ka shkelur nenin 58 të Kodit të Procedurës Penale.

Fakte dhe rrethana të çështjes

111. Pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Korçë janë dërguar materialet hetimore me shkresën nr. *** prot., datë 13.7.2020, për veprat penale “Shpërdorimi i detyrës”, “Falsifikimi i dokumenteve”, “Ndërtim pa leje”, “Prerje e paligjshme pyjesh”, të parashikuara nga nenet 248, 186, 199/a/3, 205 të Kodit Penal. Nga aktet e administruara në materialin kallëzues rezulton se në datën 8.7.2020, në emisionin investigativ “****” në ***, është publikuar një rast abuziv sipas tyre në ngarkim të shtetasit A.R, ndërtues, i cili ka ndërtuar tek Kompleksi *** apo *** shtesa pa leje përkatëse. Nisur nga fakti që kjo çështje është bërë edhe mediatike, Komisioni vendosi të kërkojë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë dosjen gjyqësore që i përket procedimit penal nr. ***. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë depozitoi fashikujt e hetimit të kryer nga organi procedural penal dhe dosjen gjyqësore me veprimet procedurale të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

112. Nga shqyrtimi i dosjes rezultoi se veprimet hetimore kanë nisur me regjistrim të katër veprave penale dhe, në përfundim, organi i procedurës penale ka vlerësuar se në rastin konkret hetimi për veprën penale “Ndërtim pa leje”, “Prerje të paligjshme pyjesh”, të parashikuara përkatësisht nga nenet 199/a/3, 205 të Kodit Penal, është i plotë, ndërkohë që është e nevojshme të ndahet çështja dhe të vijojnë hetimet për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, “Falsifikimi i dokumenteve”, të parashikuara nga nenet 248 dhe 186 të Kodit Penal.

⁶ Neni 291 - Vendimi për mosfillimin e procedimit

1. Kur ekzistojnë rrethanat që nuk lejojnë fillimin e procedimit, prokurori jep vendim të arsyetuar për mosfillimin e procedimit brenda 15 ditëve nga regjistrimi i kallëzimit.

2. Vendimi u njoftohet menjëherë atyre që kanë bërë kallëzim ose ankim, viktimës ose trashëgimtarëve të saj, të cilët kanë të drejtën e ankimit në gjykatë brenda 10 ditëve nga njoftimi i vendimit.

3. Ankimi shqyrtohet nga gjyqtari që gjykon kërkesat e palëve gjatë hetimeve paraprake, i cili jep vendim brenda 30 ditëve nga paraqitja e ankimit. Ankimi shqyrtohet në seancë gjyqësore, por, kur palët nuk paraqiten pa shkaqe të arsyeshme, gjykata vendos mbi aktet e paraqitura.

4. Kur e gjen të bazuar ankimin, gjykata urdhëron prokurorin të regjistrojë procedimin dhe të kryejë hetimet e nevojshme, duke përcaktuar edhe drejtimin e tyre.

5. Kundër vendimit palët mund të bëjnë ankim në Gjykatën e Apelit brenda 10 ditëve. Gjykata e Apelit vendos brenda 30 ditëve nga marrja e akteve.

113. Në veprimet përgatitore të kryera nga gjyqtari paraprak, në seancën paraprake të datës 4.4.2022, av. mbrojtës i të pandehurit A.R ka paraqitur një kërkesë për plotësim të veprimeve hetimore në lidhje me procedimin penal, bazuar në nenin 332/c, shkronja ç dhe 332/ç të Kodit të Procedurës Penale. Gjykata në lidhje me këtë kërkesë të palës mbrojtëse vlerësoi të studionte fashikujt e Prokurorisë (6 fashikuj) dhe të vendoste në lidhje me të, duke e shtyrë seancën gjyqësore me dy ditë dhe rifillimin e saj në datën 6.4.2022.

114. Me vendimin e datës 6.4.2022, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, pasi u njoh me aktet, çmon se nuk jemi në kushtet kur aktet t'i kthehen Prokurorisë për plotësim hetimesh dhe vlerëson se hetimet janë kryer të plota dhe pretendimet e ngritura nga avokati nuk kanë ndikim lidhur me zgjidhjen e çështjes dhe as me ndryshimin e cilësimit juridik të faktit. Më pas, gjykata kaloi në një moment tjetër procedural, tek kërtime të tjera të palëve. Mbrojtja e të pandehurit kërkoi që çështja të zgjidhet në gjendjen që janë aktet dhe kërkon gjykim të shkurtuar. I pandehuri - dakord me avokatin; Prokurorja - dakord me gjykimin e shkurtuar.

115. Gjykata, pasi u njoh me aktet e fashikullit të procedimit penal nr. ***, vendosi të pranojë kërkesën e të pandehurit për gjykim të shkurtuar dhe të shqyrtojë çështjen me procedurën e gjykimit të shkurtuar, pasi vlerëson se çështja zgjidhet në gjendjen që janë aktet, hetimet janë kryer të plota dhe nuk ka vend për kryerjen e veprimeve të tjera hetimore, fakti nuk përmban elemente të ndonjë veprë tjetër penale dhe gjykata nuk konstaton pavlefshmëri të ndonjë akti apo papërdorshmëri të ndonjë prove. Gjykata cakton si prova fashikujt e procedimit penal nr. ***, viti 2020, gjithsej 6 fashikuj.

116. Në këto rrethana, në referim të nenit 332/dh të Kodit të Procedurës Penale, i ndryshuar me nenin 17 të ligjit nr. 41/2021, gjykata vendos të vijojë gjykimin në themel të çështjes me diskutimet përfundimtare të palëve. Në bazë të nenit 332/dh të Kodit të Procedurës Penale, të ndryshuar, gjykata u bën me dije palëve se kanë të drejtë për të kërkuar kohë për diskutimet përfundimtare jo më shumë se 15 ditë.

117. Në seancën e datës 19.4.2022, palët kanë dhënë me shkrim konkluzionet përfundimtare dhe, në bazë të nenit 378 të Kodit të Procedurës Penale, i jep fund shqyrtimit gjyqësor bazuar në gjendjen që janë aktet.

118. Komisioni konstatoi nga vendimi se gjykimi është zhvilluar me procedurën e gjykimit të posaçëm (gjykim i shkurtuar). Në procedurën e gjykimit të shkurtuar, Gjykata, pasi dëgjon parashtrimin e prokurorit në të njëjtën seancë, vendos pranimin e kërkesës për gjykimin e shkurtuar, kur çmon se çështja mund të zgjidhet në gjendjen që janë aktet.

119. Me vendimin nr. ***, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë vendosi: “Bazuar në nenin 375/1 të Kodit të Procedurës Penale⁷, të bëjë ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale, nga paragrafi i tretë në paragrafin e dytë të nenit 199/a/2 të Kodit Penal”.

120. Të deklarojë fajtor të pandehurin A.G.R për kryerjen e veprës penale “Ndërtimi i paligjshëm”, parashikuar nga neni 199/a/2 i Kodit Penal dhe, në bazë të kësaj dispozite, e dënon atë me 1 vit e 6 muaj burgim.

⁷ Neni 375/1 i Kodit Penal – Ndryshimi i cilësimit juridik të veprës penale:

“Me vendimin përfundimtar gjykata mund t'i japë faktit një përcaktim të ndryshëm nga ai që ka bërë prokurori ose viktima akuzuese, më të lehtë ose më të rëndë, me kusht që vepra penale të jetë në kompetencën e saj”.

121. Në aplikim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale, të pandehurit A.G.R i ulet dënimi me 1/3-at, duke e dënuar përfundimisht me 1 vit burgim. Në aplikim të nenit 63 të Kodit Penal, pezullohet ekzekutimi i vendimit të dënimit me burgim, duke u zëvendësuar me detyrimin e të dënuarit A.G.R të kryejë 200 orë punë në interes publik.

122. Kundër vendimit nr. ***, datë 19.4.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, ka paraqitur në Gjykatën e Apelit Korçë ankim ankuesi A.R, i cili ka kërkuar ndryshimin e vendimit penal nr. ***, datë 19.4.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, duke vendosur deklarinimin e pafajshëm të të pandehurit A.R për veprën penale të parashikuar nga neni 199/a/2 i Kodit Penal. Sa më sipër, subjektit iu kërkuar të japë shpjegime në lidhje me këtë çështje.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Në lidhje me denoncimin e shtetasit S.B, ku ai pretendon se në gjykimin penal me të pandehur A.R, akuzuar për veprën penale “Ndërtimi i paligjshëm”, parashikuar nga neni 199/a/3 i Kodit Penal, nuk është thirrur si palë pjesëmarrëse në gjykim, me cilësinë e viktimës nga vepra penale, konform nenit 58 të Kodit të Procedurës Penale, shpjegoj si vijon:

*Bazuar në emisionin investigativ “***” të transmetuar, në televizionin kombëtar “***”, policia gjyqësore ka kryer një sërë veprimesh dhe ka referuar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë për veprat penale “Shpërdorimi i detyrës”, “Falsifikimi i dokumenteve”, “Ndërtimi i paligjshëm” dhe “Prerja e paligjshme e pyjeve”, të parashikuara nga nenet 248, 186, 199/a/3 e 205 të Kodit Penal. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë ka regjistruar procedimin penal nr. ***, me person nën hetim shtetasin A.R. Në lidhje me këtë procedim është pyetur dhe shtetasi S.B, i cili ndër të tjera ka deklaruar se në vitin 2007 ka blerë nga shtetasi Dh.G kompleksin *** në Malin e ***, e cila ka qenë godinë ekzistuese e ndërtuar që para viteve '90. Pas blerjes ka filluar ta përmirësojë duke investuar, pa bërë shtesa anësore në volum apo në lartësi, por vetëm riparim. Në vitin 2009 i ka shitur 50 % shtetasit A.R dhe likuidimi është bërë me lekë në dorë, e cila është konkretizuar në marrëveshje noteriale konform rregullave. Pas shitjes së 50 % të këtij objekti kanë filluar të investojnë së bashku me ortakun A.R, duke bërë edhe shtesa në kate anësore dhe ndërtime të reja, siç janë reflektuar tek leja e legalizimit. Në datën 27.3.2009 kanë krijuar biznesin privat “***” dhe i gjithë investimi është bërë së bashku me ortakun nga 50 % të investimit. I gjithë ndërtimi ka marrë formë ligjore, pasi ishte pa leje përkatëse, duke u deklaruar tek Aluizni dhe aktualisht ka dalë leja e legalizimit dhe dokumentacioni tjetër përkatës. Për të bërë lejen e legalizimit ka aplikuar ortaku A.R si person fizik, jo si përfaqësues i shoqërisë. Ai ka përdorur një dokument të falsifikuar, kontratë noteriale nr. *** rep. dhe *** kol., datë 3.5.2011, të përpiluar nga noterja M.Ç në Tiranë dhe ka falsifikuar firmën ku ai e kishte autorizuar si përfaqësues, gjë e cila nuk është e vërtetë. Për këtë ka ndjekur rrugën ligjore, duke e kundërshtuar dhe duke hartuar edhe akt ekspertimi privat tek një ekspert i licencuar, e cila ka dalë e falsifikuar. Gjatë kësaj kohe nuk ka pasur dijeni se çfarë kishte bërë A.R, por ka marrë dijeni vetëm në datën 11.5.2020, kur ka kërkuar në mënyrë zyrtare dokumentacionin pranë ASHK-së për të gjithë dokumentacionin e legalizimit që ishte paraqitur. I është bërë me dije dhe është kthyer përgjigje së bashku me dosjen dhe ka parë që emri i tij nuk figuronte në legalizim dhe, pas kësaj, ka bërë ankesë pranë ASHK-së, e cila ka dalë me vendim për korrigjimin e lejes së legalizimit të ndërtimit. Në lejen e legalizimit u vendos dhe emri i tij si bashkëpronar dhe certifikatat janë të bllokuara, pasi do të dalin certifikatat e reja. Nga ana e tij nuk është bërë asnjë lloj ndërtimi i paligjshëm tek *** dhe të gjitha janë bërë konform rregullave dhe janë legalizuar.*

*Nga ana e prokurorisë janë kryer një sërë veprimesh hetimore, si dhe është kryer ekspertim dhe riekspertim grafik me grup ekspertësh në lidhje me dokumentin e pretenduar si të falsifikuar nga shtetasi S.B. Në lidhje me veprën penale të prerjes së paligjshme të pyjeve, është kryer ekspertimi teknik dhe ka rezultuar se nuk mund të provohej fakti kur janë prerë dy drurët e llojit pishë në vendin ku i pandehuri po kryente punimet e ndërtimit. Me vendimin datë 21.2.2022, prokuroria ka bërë ndarjen e çështjes në lidhje me veprat penale “Shpërdorimi i detyrës”, “Falsifikimi i dokumenteve” dhe “Prerja e paligjshme e pyjeve”, të parashikuara nga nenet 248, 186 e 205 të Kodit Penal, duke e regjistruar si procedim penal nr. ***, kurse për veprën penale “Ndërtimi i paligjshëm”, parashikuar nga neni 199/a/3 i Kodit Penal, ka regjistruar procedimin penal nr. ***, viti 2020, ka përfunduar hetimet dhe ka paraqitur në gjykatë kërkesën për dërgimin e çështjes në gjyq.*

*Shtetasit S.B i është njoftuar vendimmarrja si më sipër, por nuk është legjitimuar me cilësinë e viktimës nga vepra penale në lidhje me këtë procedim penal. Ai është legjitimuar me këtë cilësi në procedimin e ndarë me nr. *** për veprat penale “Falsifikimi i dokumenteve” dhe “Shpërdorimi i detyrës” nga punonjësit e Bashkisë Korçë. Nisur nga ky fakt, ai nuk është thirrur në gjykim me cilësinë e viktimës nga vepra penale dhe në përfundim të gjykimit është disponuar me vendimin nr. ***, datë 19.4.2022.*

*Pas dhënies së vendimit të dënimit, vendimi është bërë objekt diskutimi përsëri në televizionin “***”, në emisionin investigativ “***”, në lidhje me veprat e tjera penale dhe faktin që gjykata është shprehur se i pandehuri ishte i padënuar ndërkohë që kishte qenë i dënuar.*

Konkluzioni i Komisionit lidhur me denoncimet

123. Trupi gjykues, pasi analizoi denoncimet e mësipërme sipas ligjit nr. 84/2016 dhe pasi analizoi shpjegimet e dhëna e dokumentacionin e paraqitur nga subjekti, nuk konstatoi të dhëna, prova dhe fakte lidhur me veprime korruptive apo shkelje ligjore të subjektit të rivlerësimit dhe nuk gjeti elemente që përbëjnë dyshime për paaftësi profesionale apo që cenojnë figurën e gjyqtarit.

Konkluzioni për vlerësimin e aftësisë profesionale

124. Trupi gjykues, bazuar në konstatimet e mësipërme, argumentet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, si dhe bazuar në kreun II të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pas një analize në përputhje me ligjin nr. 84/2016 “Për vlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, konkludon se në përfundim të procesit të rivlerësimit të aftësive profesionale subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues.

KONKLuzion Përfundimtar

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatores të çështjes, zhvilloi seancën dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit z.Seladin Pysqyli:

- a. nuk ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale;

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues, bazuar në nenet 179/b, A, Ç, D, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në pikën 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z.Seladin Pysqyli, gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ndaj këtij vendimi mund të ushtrohet ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë më 25.7.2024.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Alma FASKAJ
Kryesuese

Xhensila PINE
Relatore

Pamela QIRKO
Anëtare

Sekretare gjyqësore

Mevi Dibra